



TIPOLOGJITË E PASTRIMIT TË PARAVE

KOSOVË



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Tipologjitë e Pastrimit të Parave: Kosovë

Maj 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
Pastrimi i parave.....	6
Qasja e bazuar në risk.....	8
Veprat penale bazë.....	9
Subjektet raportuese.....	19
TIPOLOGJITËSEKTORIALE	21
Sistemi financiar.....	22
Shërbimet bankare.....	23
Mikrofinancimi.....	38
Sigurimi i jetës.....	42
Fondet pensionale.....	46
Shërbimet e transfereve të parave.....	48
Ofruesit e këmbimit të monedhës.....	53
Bizneset dhe profesionet përcaktuarajo-financiare (BPPJF)	59
Avokatët.....	60
Kontabilistët dhe auditorët.....	66
Subjektet dhe aranzhimet juridike.....	69
Noterët.....	77
Tregtarët me vlera të larta.....	79
Patundshmëria dhe ndërtimtaria.....	82
Kazinotë dhe lojërat e fatit.....	92
Organizatrat jo-fitimprurëse qeveritare (OJFOJQ).....	96

1. HYRJJE

Ky raport për tipologjitë e pastrimit të parave është pjesë e përpjekjeve të Kosovës Njesisë për Inteligjencë Financiare për uljen e niveliteve të korrupsionit, ekonomisë informale dhe veprave tjera të ndërlidhura të PP/FT dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve subjekteve raportuese në mënyrë efikase, transparente, llogaridhënëse, si dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.

Konsiderohet se institucionet e Kosovës kundër korrupsionit, në veçanti organet e shtypjes së korrupsionit, siç janë prokuroria, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF), do të përfitonin nga kapacitetet e rritura për zbulim, hetim dhe ndjekje penale të veprave të korrupsionit.

Skemat e korrupsionit të madh patjetër përfshijnë pastrimin e parave, qoftë përmes blerjeve të pasurive të patundshme, konsulencës fiktive apo shërbimeve të tjera fiktive për firmat, evazionit tatimor, kredive të dyshimta dhe skemave të tjera të jashtëligjshme financiare. Shpesh, këto lloje të veprimtarive kriminale janë skema të

komplikuara financiare të dizajnuara për të penguar dhe shmangur rregullatorët dhe hetuesit financiarë. Për të zbuluar flukset e jashtëligjshme financiare, rregullatorët dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet së pari të kuptojnë si funksionojnë këto skema dhe të gjitha pjesët e sistemit kundër pastrimit të parave; nga zyrtarët e pajtueshmërisë në sektorin privatsubjektet raportuese dhe deri tek hetuesit dhe gjyqtarët përfundimisht, duhet të kuptohet si keqpërdoret sistemi financiar nga këto lloje të kriminelëve për të pastruar fitimet parat e tyre që burojnë nga aktivitetet kriminale.

Në këtë drejtim, ky raport do të sigurojë mbështetje për NjIF-in në luftën e këtij institucioni kundër veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT) dhe veprave të korrupsionit, duke qenë se do të hedhë dritë mbi risqet sektoriale të pastrimit të parave që lidhen me veprat penale bazë dhe cenueshmëritë aktuale mes subjekteve raportuese kombëtare.

Qëllimi i këtij raporti është përmirësimi i masave të pajtueshmërisë dhe sigurimi i informacionit shtesë për hetuesit dhe autoritetet e mbikëqyrjes në lidhje me rastet e pastrimit të parave në Kosovë.

Pastrimi i parave

Kriminelët nuk mund t'i depozitojnë fitimet e krimit në banka pa tërhequr vëmendjen e autoriteteve. Kjo do të siguronte provat e krimeve që ata kryejnë. Sidoqoftë, që kriminelët t'i përdorin paratë, ato duhet të futen në ekonominë zyrtare, çka kërkon një proces paraprak pastrimi.

FATF e përcakton Pastrimin e Parave si "përpunimi i këtyre të ardhurave të krimit për të maskuar origjinën e tyre të paligjshme (...) që i mundëson kriminelit t'i shijojë këto fitime pa rrezikuar burimin e tyre".

Meqenëse pastrimi i parave është pasojë e pothuajse të gjitha krimeve që gjenerojnë fitim, natyra e tij është vetvetiu ndërkombëtare. Kriminelët mund të jenë më të prirur për pastrimin e fondeve në vende ose sektorë ku supozohen risqe më të ulëta të zbulimit për shkak të programeve më të dobëta për PPP. Në të njëjtën kohë, duke qenë se kriminelët duan që përfundimisht të përdorin fonde të paligjshme të pastruara, zakonisht ata preferojnë të transferojnë fonde përmes qendrave stabile financiare.

FAZAT E PASTRIMIT TË PARAVE

1

VENDOSJA

Fondet, nga lidhja e drejtpërdrejtë me krimin, kalojnë në Sistemin Financiar. Kjo mund të bëhet duke ndarë shuma të mëdha parash në shuma më të vogla që depozitohen më pas nëpër llogari, ose duke blerë instrumente monetare që depozitohen nëpër llogari në vende të tjera.

2

SHTRESIMI

Gjurmët e parave maskohen nga shpëlarësi që angazhohet në lëvizjen e parave për t'i distancuar ato nga burimi. Shpesh, shpëlarësi mund t'i transferojë fondet përmes llogarive të ndryshme në mbarë globin, posaçërisht në juridiksione që nuk bashkëpunojnë në hetimet e pastrimit të parave.

3

INTEGRIMI

Fondet ri-hyjnë në ekonominë e ligjshme pas përpunimit me sukses të fitimeve të krimit në fazat e vendosjes dhe shtresimit. Fondet shpenzohen përmes investimeve në pasuri të patundshme, asete luksoze ose ndërmarrje biznesi, për të përmendur disa.

Qasja e bazuar në risk (QBR)

QBR-ja në PPP/KFT LFT do të thotë që vendet, autoritetet kompetente dhe subjektet raportuese pritet të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë risqet për PP/FT ndaj të cilave ata janë të ekspozuar dhe të marrin masa për PPP/KFT në përpjesëtim me ato risqe, në mënyrë që ato të zbuten në mënyrë efektive dhe efikase.

Për ta arritur këtë, vendet, autoritetet kompetente, si dhe subjektet raportuese, duhet të analizojnë risqet për PP/FT ndaj të cilave ata janë të ekspozuar dhe të marrin masa të përshtatshme për t'i lehtësuar dhe menaxhuar këto risqe. Po ashtu, Qasja e Bazuar në Risk lejon adoptimin e masave më fleksibile për uljen e kërcënimeve të risqeve duke pasur si objektiv shënjestrimin e burimeve kriminale në mënyrë më të efektshme, ndërkohë që aplikohen masa parandaluese në përpjesëtim me natyrën e risqeve.

Pra, zbatimi i QBR-së nuk është opsional, por parakusht për një zbatim efektiv të Rekomandimeve të FATF-së për PPP/KFT. Qeveritë, sektori privatN-jIF-K, mbikëqyrësit sektorial, subjektet raportuese dhe shoqëritë civile duhet të punojnë së bashku për ta arritur këtë.

Veprat penale bazë

Sipas Rekomandimit 1 të 40 Rekomandimeve të FATF-së për PPP/KFT, vendet duhet të aplikojnë krimin e pastrimit të parave ndaj të gjitha veprave të rënda penale, me qëllim që të përfshihet një gamë e gjerë e veprave penale bazë.

Paraja është faktori kryesor shtytës në aferat e trafikut të drogës, korrupsionit, evazionit tatimor, mashtrimit, vjedhjes, trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës. Këto krime shkaktojnë humbje të drejtpërdrejta financiare për individët, dëmtojnë komunitetin, dhe në disa raste sjellin edhe humbjen e jetës njerëzore. Pastrimi i suksesshëm i parave u mundëson kriminelëve të shijojnë fitime dhe të nxisin ciklin e kriminalitetit duke siguruar fonde për ri-investim në krim.

Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe mbajtjen e politikave për PPP/KFT për të rritur aftësinë e vet për t'iu përgjigjur risqeve në zhvillim për PP/FT dhe për të siguruar luftimin efektiv të PP/FT-së. Pastrimi i parave është një pasojë e domosdoshme e të gjitha krimeve që gjenerojnë fitime, dhe teksa është e vështirë të vlerësohet me saktësi sa para janë pastruar në Kosovë, ka gjasa që shifrat të jenë qindra miliona euro çdo vit.

Shkalla e cenueshmërisë¹ nga veprat e ndryshme penale bazë ndaj të cilave është e ekspozuar Kosova, u vlerësua në përputhje me krimet me të cilat ishin të lidhura aktivitetet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit: sa më e lartë është sasia e aktiviteteve të PP/FT-së të lidhura me një vepër të veçantë bazë, aq më e lartë është cenueshmëria e Kosovës nga kjo vepër².




Figura 1: Veprat penale bazë - shkalla e cenueshmërisë ndaj së cilës është e ekspozuar Kosova.

Evazoni tatimor si dhe korrupsioni dhe ryshfeti janë veprat penale bazë, ndaj të cilave Kosova është më shumë e ekspozuar. Brenda vendit, evazoni tatimor

shoqërohet me informalitetin e përhapur të ekonomisë dhe nivelet e larta të intensitetit të parave të gatshme, çka gjeneron mundësi për të shmangur pagimin e tatimit në të hyra dhe të TVSH-së, një nga burimet kryesore të financimit të qeverisë. Nga ana tjetër, korrupsioni dhe ryshfeti janë të pranishëm në forma të ndryshme në mbarë juridiksionin, kurse aktivitetet që prodhojnë shumën më të lartë të fitimeve nga krimi janë të lidhura me prokurimin publik.

Pjesa më e madhe e fitimeve të shumicës së llojeve të krimeve marrin formën fillestare të parave të gatshme, për të cilat përdoren metoda relativisht jo të sofistikuar të pastrimit. Kjo lehtësohet nga nivelet e larta të informalitetit të ekonomisë kosovare, çka e bën të vështirë të dallohet nëse fondet janë marrë në mënyrë të ligjshme apo jo. Mashtrimi dhe korrupsioni janë të vetmet vepra penale bazë që besohet se pjesën më të madhe të fitimeve të tyre e kanë në formën e asetëve financiare. Asetet financiare lehtësojnë gjurmueshmërinë e parave.

→ **Niveli i kërcënimit - jashtëzakonisht i lartë**

- Evazioni tatimor: Evazioni tatimor është i përhapur në Kosovë, siç tregohet nga një raport i Bankës Botërore i vitit 2014, që arriti në përfundimin se hendeku i TVSH-së ishte 34% (180 milionë euro), hendeku tatimor në të hyrat e korporatave është rreth 17% (10 milionë euro), ndërkohë që hendeku tatimor në të hyrat personale është 66% (180 milionë euro). Në mënyrë të ngjashme, një studim i vitit 2017 për ekonominë informale konstatoi se hendeku tatimor i kalon 300 milionë euro në vit. Evazioni tatimor mund të lidhet kryesisht me ekonominë informale (që supozohet se arrin në 30% të ekonomisë së përgjithshme), çka lejon që të ardhurat të mos raportohen dhe për këtë arsye të mos taten. Sa i përket evazionit tatimor në të hyrat personale, konsiderohet se ky është i lidhur me faktin se sistemi tatimor i Kosovës nuk përfshin dorëzimin e deklaratave individuale tatimore.

Raportimi i ulët është një fenomen i zakonshëm në Kosovë, i mundur nga informaliteti i ekonomisë,

pasi të hyrat e raportuara tek autoritetet tatimore nuk pasqyrojnë të hyrat reale. Për shembull, kompanitë shpesh nuk japin informacion të saktë mbi të ardhurat që gjenerojnë.

Në një masë më të ulët, ka edhe raste të skemave më të stërholluara të evazionit tatimor, ku kompanitë gjenerojnë fatura të rreme në mënyrë që të zvogëlojnë në mënyrë të padrejtë të hyrat e pagueshme.

Për më tepër, shumica e ekonomisë informale është e bazuar në para të gatshme, dhe një përqindje e madhe e kësaj ekonomie shmang pagimin e tatimeve. Këto fitime të paligjshme shpesh mund të hyjnë në sistemin financiar si depozita të thjeshta. Sidoqoftë, mashtrime më të stërholluara tatimore mund të përfshijnë fatura mashtruese.

Edhe pse besohet gjerësisht se shumica e fitimeve nga evazioni tatimor mbesin brenda Kosovës, partneritetet ndërkombëtare kanë qenë thelbësore në hetimin dhe ndjekjen penale të transaksioneve ndërkufitare që përfshijnë evazion tatimor. Përforcimi i bashkëpunimit ndërkuf-

itar mbetet një nga prioritetet kryesore për Kosovën.

- Kontrabanda: Ky krim, ashtu si krimet e tjera të trafikimit, lehtësohet nga kufiri poroz i Kosovës. Kontrabanda e mallrave nga Serbia në Kosovë mbetet në qendër të vëmendjes së grupeve kriminale, dhe produktet e Serbisë janë shpesh të pranishme në tregun e brendshëm, me çmime konkurruese. Mallrat kontrabandë janë kryesisht derivate, barna farmaceutike, produkte qumështi, pemë, mish, cigare, kafe, pije alkoolike, perime, vegla bujqësore, pajisje elektronike dhe tekstile.

Kontrabanda është veçanërisht e shpeshtë në Kosovën e veriut, por edhe rajoni i Gjilanit ka një shkallë të lartë të kontrabandës. Kontrabandistët përdorin automjete të ndryshme transportuese si kamionë, makina, traktorë, kombi dhe linja të rregullta autobusi. Me gjithë trendin në rënie, duhani është një nga produktet kryesore të ekspozuara ndaj kontrabandës, me Malin e Zi dhe Shqipërinë si burimet kryesore.

Kontrabanda bën përdorim intensiv të parave të gatshme, dhe konsiderohet se shumica e fitimeve kthehen në vendin nga i cili kontrabandohen produktet.

- Korrupsioni dhe ryshfeti: në vitin 2019, Kosova u vlerësua me 36/100 nga Transparency International, duke u renditur në vendin 101 nga 180 në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit. Mungesa e transparencës në procesin e prokurimit publik, së bashku me financimin e partive politike, mbeten shqetësimet kryesore.

Një nga sektorët më të cenueshëm të ekonomisë është sektori i ndërtimit, ku paguhen ryshfete për të marrë trajtim më të mirë gjatë procesit administrativ ose për një autorizim. Për pasojë, më shumë se 100 milionë euro shpërdorohen çdo vit për korrupsion, ndërkohë që në 20% të kontratave të lidhura çdo vit në Kosovë ka abuzime nga zyrtarët publikë.

Në shumë shtete korrupsioni i vogël perceptohet si korrupsion i zyrtarëve të vegjël ose të mesëm të lartë që ndodh në kuadër të ad-

ministratës publike. Në Kosovë, këtu përfshihen institucionet publike përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike në komuna, administrata tatimore, shërbimet shëndetësore, arsimit, si dhe shërbimet komunale dhe kadastrale. Në përgjithësi besohet se shumica e krimeve të pastrimit të parave të lidhura me sa më lart kanë gjasa të marrin formën fillestare të parave të gatshme dhe kriminelët besohet se përdorin skema të thjeshta pastrimi.

Korrupsioni i madh zakonisht ndodh në pozita të nivelit të lartë, si udhëheqës i divizionit ose departamentit në kuadër të një ministrie të caktuar, sekretarë të përhershëm dhe pozita të tjera të nivelit të lartë me ndikim në qeveri ose agjenci publike, ose gjyqtarë dhe prokurorë. Zyrat e prokurimit, doganat dhe autoriteti fiskal janë sektorët më të ekspozuar ndaj risqeve të pastrimit të parave.

Teksa numri i rasteve të korrupsionit të vogël e tejkalon në masë të madhe korrupsionin e madh, besohet fuqishëm se të ardhurat e lidhura me korrupsionin e madh për-

bëjnë shumicën e të ardhurave nga korrupsioni në Kosovë. Konflikti i interesit dhe nepotizmi janë ndoshta problemet më të mëdha që lidhen me korrupsionin në Kosovë.

Ndërkohë që korrupsioni në shkallë më të vogël mund të realizohet me para të gatshme, korrupsioni në shkallë më të madhe dhe i lidhur me prokurimin zakonisht përfshin kompani të regjistruara dhe persona të ekspozuar politikisht (PEP). Përdorimi i kompanive mbulesë lehtëson shmangien e shqyrtimit të rreptë të bankave. Besohet se shumica e fondeve qëndrojnë brenda Kosovës, ndërsa kompanitë e pasurive të patundshme dhe ndërtime të tjera janë mjeti mbizotërues i përdorimit të fondeve.

Personat e Ekspozuar Politikisht

Në vitin 2018, UNDP-ja në Kosovë lansoi Raportin e parë për Tipologjitë e Pastrimit të Parave të Personave të Ekspozuar Politikisht në Kosovë (vegza), me objektiv sigurimin e udhëzimeve për subjektet raportuese se si të angazhohen me PEP-të si klientë, të monitorojnë risqet dhe të identifikojnë treguesit e sinjalit të alarmit që mund të kërkojnë dorëzimin e raporteve në NjIF.

→ **Niveli i kërcënimit - i lartë**

- Trafiku i drogës: një tjetër vepër penale me përdorim intensiv të parave të gatshme, me fitime të lidhura me shitjen e drogave të paligjshme në Kosovë që vijnë kryesisht nga opiatet dhe kanabisi, dhe në një shkallë më të ulët nga kokaina dhe stimulues të llojit të amfetaminës. Përdorimi lokal i drogave nuk është i përhapur, megjithëse perceptohet të jetë rritur pak gjatë viteve të fundit si rezultat i rritjes së përmasave të ekonomisë lokale, si dhe rritjes mesatare në të hyrat e disponueshme të popullatës. Kosova është një vend tranzit për droga të kontrabanduara në tregjet e tjera evropiane.
- Falsifikimi i mallrave dhe pirateria: Dëshmitë sugjerojnë se ka pak prodhim vendas të mallrave të falsifikuara në Kosovë, por është shqetësues importimi i mallrave të falsifikuara, veçanërisht i veshmbathjeve dhe në një shkallë më të vogël i mallrave elektronike. Prevalenca e produkteve të falsifikuara dhe pirate në Kosovë është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së kaluar në aspektin e sasisë dhe gamës së

produkteve të disponueshme për shitje, dhe ka arritur një shkallë ku tregjet dhe shitoret më të vogla të shitjes me pakicë shihen shpesh të tregtojnë haptazi mallra të falsifikuara. Kina është burimi kryesor i produkteve të falsifikuara të importuara në Kosovë. Masat mbrojtëse të drejtave të pronës intelektuale po përmirësohen ngadalë, por kufizohen nga mungesa e vazhdueshme e vetëdijesimit në sistemin publik dhe gjyqësor.

Qeveria regjistron dhe raporton për konfiskimet e mallrave të falsifikuara. Në vitin 2016, Dogana konfiskoi mallra të falsifikuar me vlerë mbi 2.5 milionë euro. Ndërkohë që shitja përfundimtare në nivel të shitjes me pakicë në përgjithësi bëhet me para të gatshme, tregtia ndërkombëtare në nivel shumice zhvillohet pothuajse ekskluzivisht nëpërmjet sistemit financiar.

- Trafikimi i qenieve njerëzore: në vitin 2018, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve e klasifikoi Kosovën si Nivel 2, që do të thotë se vendi nuk e plotëson plotësisht standardin ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ag-

jencitë qeveritare dhe të zbatimit të ligjit po e trajtojnë aktivisht këtë problem.

Trafikimi i qenieve njerëzore lidhet kryesisht me shfrytëzimin seksual. Shumica e viktimave të kësaj tregtie janë gra që vijnë nga Evropa Lindore, veçanërisht Shqipëria, Moldavia, Bullgaria, Rusia dhe Ukraina. Moshë mesatare e viktimave është mes 20 dhe 35 vjeç, dhe janë kryesisht gra të rekrutuara në vendlindjen e tyre me shpresën për një punë dhe jetë më të mirë në Evropë. Në vitet e fundit, statistikët e policisë nënvizuan një rritje të rasteve, të nxitur edhe nga një rritje e trafikimit të të miturve.

Pothuajse të gjitha fitimet marrin formën fillestare të parave të gatshme, me pjesë të rëndësishme të fitimeve që mund të kthehen në vendin e origjinës së grupit të krimit të organizuar. Disa nga fitimet kanë gjasa të hyjnë në sistemin financiar në Kosovë në masën që kriminelët mund të përdorin hotele lokale dhe pagesa mund të bëhet në mënyrë elektronike.

Kontrabanda ndërkombëtare e migrantëve që kalojnë përmes Kosovës ka qenë në rënie të fuqishme në vitet e fundit, sidomos në lidhje me personat me origjinë siriane dhe afgane. Migrantët e kontrabanduar ilegalisht përmes të ashtuquajturave "Rrugë Ballkanike", vijnë nga kufijtë jugorë me Maqedoninë e Veriut dhe vazhdojnë udhëtimin e tyre drejt Evropës përmes Serbisë ose nga portet e Shqipërisë. Sidoqoftë, shumë pak nga fitimet konsiderohen të jenë të lidhura me Kosovën, pasi pagesat që lidhen përgjithësisht me kontrabandimin e emigrantëve bëhen në vende të tjera.

Migrimi i kategorive të caktuara të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve të Evropës Perëndimore është një fenomen aktual. Migrantët janë kryesisht persona në kushte të vështira ekonomike, të papunë ose të punësuar kryesisht në sektorin privat, me paga të ulëta ose mesatare, me ndihmë sociale, disa janë me çështje të pazgjidhura të strehimit, të pakënaqur me politikat për shëndetësi, pensione, siguri dhe arsim. Megjithatë, konsiderohet se janë të pakta fitimet e krimit

të lidhura me kontrabandën e migrantëve, duke pasur parasysh kufirin relativisht poroz të Kosovës.

- Prostitucioni: prostitucioni është i paligjshëm në Kosovë dhe funksionon me disa mbivendosje me trafikimin e qenieve njerëzore. Dallimi është se ky i fundit përfshin kërcënimin ose përdorimin e forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, ndërsa prostitucioni nuk parashikon asnjë lloj të shtrëngimit. Vitet e fundit ka pasur një rritje të numrit të lokaleve të masazhit të cilat besohet se kanë lidhje me prostitucionin.

Prostitucioni dihet se gjeneron shuma të konsiderueshme parash (rreth 30-50 euro për klient), pothuajse ekskluzivisht në para të gatshme. Shumica e vajzave që punojnë nuk janë kosovare por nga vende si Bullgaria, Rumania dhe Moldavia. Shumica e parave të gjeneruara transferohen përfundimisht jashtë vendit.

→ **Niveli i kërcënimit - mesatar**

- Mashtrimi: Mashtrimi paraqitet në shumë forma në Kosovë, por mashtrimet në shkallë të gjerë me produkte financiare dhe investuese, siç janë skemat e mëdha piramidale, nuk duket se janë një kërcënim i konsiderueshëm. Kjo ka gjasa të jetë e lidhur me nivelin relativisht të ulët të produkteve të sofistikuara të investimeve të ofruara nga sistemi financiar në Kosovë. Klonimi i kartave të kreditit është lloji më i shpeshtë i mashtrimeve në Kosovë, por nuk konsiderohet një problem i përhapur. Mashtrimet që lidhen me mashtrimet me email, të tilla si mashtrimet me email nga Nigeria, paraqesin risk edhe në Kosovë. Kohët e fundit ka pasur një rritje në rastet e mashtrimit nga agjencitë turistike, ku janë shitur bileta dhe paketa mashtruese të pushimeve. Keqpërdorimi i benefiteve shtetërore ka gjasa që ndodh edhe në Kosovë. Rastet e mashtrimit në Kosovë janë përgjithësisht të lidhura me krimin e organizuar ndërkombëtar, me pagesat që kryesisht bëhen me asete financiare, dhe në krahasim me shumicën e llojeve të tjera të krimit në Kosovë, shfaqin

nivele shumë të larta të sofistikimit dhe të aftësive në lidhje me pastrimin e fitimeve të lidhura me mashtrimin.

- Zhvatja dhe fajdet: Në Kosovë janë zbuluar disa raste të fajdeve, ku individët kanë marrë kredi dhe u është kërkuar t'i paguajnë kreditë me interes në rritje, dhe teksa informacioni i bazuar në rastet e raportuara nuk është gjerësisht i përhapur, besohet se shumë raste nuk raportohen, pasi personat që marrin para përmes fajdeve hezitojnë ta raportojnë krimin.

Fajdet lidhen në përgjithësi me individët që nuk mund të marrin kredi nëpërmjet sistemit financiar ose kanë nevojë urgjente për para. Janë identifikuar grupe të organizuara dhe të strukturuara kriminale, por deri më tani shumica e rasteve përfshijnë individë dhe grupe të vogla kriminale.

Zhvatja nuk është një fenomen i zakonshëm në Kosovë, dhe kompanitë nuk përballen me kërcënime të konsiderueshme. Në Kosovë, përveç që kryesisht lidhet me fajdet, zhvatja

manifestohet përmes kërcënimeve, shantazheve, dhe shumica e rasteve të raportuara janë kryesisht raste të vogla ose individuale, ku kriminelitë takohet personalisht me viktimat për t'i kërcënuar ose për të marrë paratë. Kërcënimet rrallë bëhen me telefon. Pagesat në rastet e zhvatjes dhe të fajdeve zakonisht bëhen në para të gatshme, dhe pjesa dërrmuese e tyre ka gjasa të mbetet brenda Kosovës.

- Grabitja dhe vjedhja: Krimet e rrugës (vjedhja, grabitja e çantave) nuk shihen si problem i zakonshëm në Kosovë dhe nuk shfaqen si shqetësim i përgjithshëm në jetën e përditshme. Në përgjithësi, njerëzit nuk mbajnë më sasi të mëdha parash të gatshme në shtëpi, gjë që ka ulur fitimet nga vjedhjet. Ka raste të vjedhjes së makinave, por janë në rënie, dhe makinat vjedhura zakonisht përdoren për pjesë. Ka raste të institucioneve private, si markete ose pompa të benzinës që janë objekt i vjedhjes, por në përgjithësi vlera e vjedhur nuk është e madhe. Megjithatë, ka disa shenja të grabitjeve më të shpeshta dhe të dhunshme të institucioneve financiare. Në përgjithësi fitimet nga grabitja dhe vjedh-

ja konsiderohen të jenë pak milionë euro.

→ **Niveli i kërcënimit - i ulët**

- Krimet mjedisore: Ndërtimet pa kritere, teknologjitë e vjetruara, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi i dobët i deponive të mbetjeve industriale dhe shtëpiake, dhe shfrytëzimi i egër i resurseve natyrore, paraqesin probleme të mëdha mjedisore në vend. Ndotja e ajrit në zonat urbane dhe sidomos në zonat industriale vlerësohet të jetë e lartë. Niveli i lartë i varfërisë dhe ekonomia informale ushtrojnë presion shtesë mbi tokën, domethënë kërcënojnë kapacitetin e tokës “ekonomike dhe mjedisore”. Teksa këto çështje mjedisore janë me të vërtetë serioze, ato nuk gjenerojnë drejtpërdrejt fitime që pastrohen. Prerjet e paligjshme kryhen në shumë forma në Kosovë, duke përfshirë prerjet pa leje nga pyjet publike, prerjet në zonat e mbrojtura, deklarimin e rremë të vëllimit të drurit të prerë dhe prerjet e paligjshme nga pyjet private: Kontrabanda dhe praktikat e paligjshme të kontabilitetit e zgjerojnë listën edhe më tej. Prerjet e paligjshme kanë edhe një dimen-

sion transnacional, dhe mungesa e kapaciteteve për të mbrojtur pyjet në Kosovë do të thotë se pyjet publike dhe private, në veçanti në kufi, janë të cenueshme dhe cak kryesor i vjedhësve të drurit.

Megjithatë, ka pasur një rënie të fortë në prerjet e paligjshme më sistematike, pasi shumica e drunjve tashmë janë prerë, dhe krimi nuk ka më lidhje të konsiderueshme me krimin e organizuar në Kosovë. Pjesa më e madhe e atyre që mbeten janë individët që presin dru në mënyrë të paligjshme për shkak të situatave të dobëta ekonomike, kryesisht për furnizim vetanak ose për shitje për të përmbushur nevojat themelore. Prandaj nuk konsiderohet aktualisht një burim i rëndësishëm për fitimet e krimit.

Duke pasur parasysh natyrën e krimit, fitimet do të marrin formën e aseteve fizike (d.m.th. dru) dhe për aq sa shiten, në përgjithësi do të shndërrohen në para të gatshme. Në historinë e kohëve të fundit ka pasur raste të mihjes së paligjshme dhe deponimit të paligjshëm të mbeturinave, p.sh. në shtretërit e lumenjve, megjithatë ky nuk shihet aktualisht

si kërcënim i rëndësishëm dhe nuk ka gjasa që aktualisht të gjenerojë fitime të konsiderueshme.

- Trafiku i paligjshëm i armëve: Tregtia e paligjshme e armëve në Kosovë nuk konsiderohet një krim madhor në krahasim me kontrabandimin e qenieve njerëzore apo mallrave të tjera. Nuk ka pasur kërkesa për armë të vogla dhe municione të reja, duke marrë parasysh sasinë e armëve dhe municioneve të disponueshme nga konflikti i armatosur i kohëve të fundit. Tregu kriminal për blerjen e armëve të paligjshme konsiderohet të jetë i vogël. Përveç kërkesës relativisht të ulët, edhe çmimi mesatar konsiderohet të jetë i ulët.

Një prirje e fundit janë armët me gaz, të cilat janë të paligjshme në Kosovë, por mund të blihen ligjshme në disa nga vendet fqinje dhe më pas kontrabandohen në Kosovë. Kjo shoqërohet vetëm me pastrimin e parave deri në shkallën që këto shiten në Kosovë. Njësitë e policisë të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë kanë kapur rreth 239 armë dhe 2,584 lloje të ndryshme municionesh gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018.

→ **Niveli i kërcënimit - jashtëzakonisht i ulët**

- Falsifikimi: Falsifikimi në Kosovë është kryesisht një krim që lidhet me kontrabandimin e migrantëve, me vizat dhe pasaportat e falsifikuara të nevojshme për të kaluar kufirin, sidomos nëse destinacioni janë vendet evropiane të Shengenit. Kërkohej një sasi e konsiderueshme e ekspertizës teknike për të falsifikuar bindshëm pasaportat evropiane - diçka që nuk mund të bëhet pa një organizim të duhur logjistik.

Konsiderohet se shumica e pasaportave të rreme evropiane në Kosovë prodhohen dhe shiten jashtë Kosovës, me çmime që shkojnë nga 1,000 deri në 4,000 dollarë amerikanë.

- Falsifikimi i monedhës: Pavarësisht se në vitin 2017 doganat e Kosovës konfiskuan mbi 2 milionë euro të falsifikuara në pikëkalimin kufitar me Shqipërinë (Vermicë), monedha e falsifikuar nuk është një problem i përgjithshëm dhe zakonisht kryhet nga individë oportunistë që prodhojnë produkte me cilësi të ulët që nuk gjenerojnë shumë fitim (nëse ka të tillë).

- Trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura: Kjo veprimtari kriminale nuk është e konsiderueshme në Kosovë, por në përgjithësi lidhet me dy lloje të mallrave: 1) makina të vjedhura dhe 2) objekte antike. Vjedhja e makinave në Kosovë është e ulët dhe po zvogëlohet. Makinat që vidhen në përgjithësi çmontohen dhe pastaj rishiten për pjesë në nivel kombëtar. Vlera monetare e objekteve të lashta në Kosovë në përgjithësi konsiderohet shumë e ulët dhe nuk ka prova për ekzistencën e një tregu kriminal për to.

Subjektet raportuese

Është me shumë rëndësi të kuptohen metodat e ndryshme të përdorura nga këta kriminelë për të vendosur, shtresuar dhe integruar paratë “e pista” në ekonominë formale. Subjektet raportuese dhe cenueshmëritë me të cilat ato përballen janë vendimtare në trajtimin e risqeve të pastrimit të parave pasi këto institucione janë instrumentet përmes të cilave fshihen dhe injektohen në sistem fitimet nga krimi.




Figura 2: Subjektet raportuese - shkalla e cenueshmërisë ndaj së cilës është e ekspozuar Kosova.

Ngjashëm me veprat penale bazë, cenueshmëria e subjekteve raportuese në Kosovë ndaj risqeve të pastrimit të

parave u vlerësua në bazë të numrit të RTD-ve të marra prej tyre: sa më e lartë të jetë sasia e RTD-ve për PP/FT, aq më e lartë është cenueshmëria e sektorit ekonomik.

Me gjithë kontrollet e forta për PP/FT dhe të kuptuarit e mirë të risqeve në kuadër të sektorit bankar, ky sektor konsiderohet më i cenueshmi në Kosovë për shkak të natyrës, shkallës dhe kompleksitetit të tij. Për më tepër, pranohet se sektori i pasurive të patundshme dhe ndërtimtarisë është shumë tërheqës për aktivitetet e pastrimit të parave, pjesërisht si rezultat i natyrës me vlerë të lartë të transaksioneve brenda sektorit, dhe gjithashtu si rezultat i intensitetit të përdorimit të parave të gatshme, çka u lejon kriminelëve të fshehin lidhjen e tyre me fondet kriminale. Korrupsioni dhe ryshfeti përbëjnë një nga veprat kryesore penale bazë të lidhura me këtë sektor, dhe kjo duhet të rezultojë në ndarjen e burimeve për identifikimin dhe zbatimin e masave për trajtimin e saktë të PEP-ve.

Efektet socio-ekonomike të flukseve financiare kriminale në ekonominë e ligjshme dhe shoqëri janë shumë të mëdha. Ato përfshijnë elementët e mëposhtëm: shtrembërime në alokimin e burimeve nga investime me rendiment të

lartë në investime që paraqesin risk të ulët zbulimi, shtrembërim të çmimeve, veçanërisht në sektorin e pasurive të patundshme, konkurrencë të padrejtë, risqe të zëvendësimit të aktiviteteve të ligjshme, ndikim negativ në investimet e huaja direkte, korrupsion, risqe të paqëndrueshmërisë së sektorit real, dhe forcim të të hyrave të shtrembëruara.

2. TIPOLOGJITË SEKTORIALE

Seksioni vijues ilustron risqet e pastrimit të parave në kuadër të sektorëve të ndryshëm ekonomikë të Kosovës. Për këtë qëllim jepen ilustrime me raste reale, së bashku me një analizë të risqeve që ato përfaqësojnë, si dhe trendet në zhvillim.

Të gjitha rastet e ilustruara besohet se portretizojnë risqet më të larta të pastrimit të parave në kuadër të secilit prej sektorëve ekonomikë të Kosovës, pasi këto janë transaksionet më të përsëritura të raportuara nga subjektet raportuese.

Sistemi financiar

Institucionet financiare në mbarë botën përballen me sfida të rëndësishme në luftën kundër krimit financiar. Karakteri i tyre ndërkombëtar është një nga sfidat kryesore: për shkak të ndërlidhjes së personave në mbarë botën, transaksionet lënë gjurmë ndërkombëtare. Kjo do të thotë se pavarësisht përpjekjeve kombëtare për mbrojtjen e integritetit të sistemeve financiare lokale, nëse masat efektive dhe efikase për PPP/KFT nuk zbatohen nga të gjitha institucionet financiare në mbarë botën, risku përhapet në krejt sistemin financiar botëror.





Shërbimet bankare

Sipas Task Forcës për Veprimin Financiar, shërbimet bankare përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

- Shërbimet bankare me pakicë: ofrimi i produkteve dhe shërbimeve direkt për klientë personalë dhe të biznesit (përfshirë aranzhimet juridike), siç janë llogaritë rrjedhëse, produktet e kredive dhe kursimit;
- Shërbimet bankare për korporata dhe investime: sigurimi i financave për korporata dhe i produkteve bankare për korporata, si dhe i shërbimeve të investimeve për korporatat, qeverinë dhe institucionet;
- Shërbimet e investimeve (ose menaxhimi i pasurisë): sigurimi i produkteve ose shërbimeve për të menaxhuar pasurinë e klientëve (të njohur edhe si Shërbime Private Bankare);
- Shërbime bankare korrespondente: ofrimi i shërbimeve bankare nga një bankë ("banka korrespondente") për një bankë tjetër ("banka respondente").

Pothuajse të gjithë të rriturit në Kosovë përdorin një bankë për shërbime financiare thelbësore për funksionimin e të

gjitha llojeve të bizneseve në kuadër të ekonomisë formale. Në Kosovë vepronë dhjetë banka komerciale, që përfaqësojnë 67.5% të totalit të aseteve në sektorin financiar, tetë nga të cilat janë në pronësi të huaj dhe përbëjnë rreth 88.9% të totalit të aseteve të sistemit bankar. Dy banka vendase vendore përbëjnë 11.1 përqindësin e mbetur.

Sistemi bankar i Kosovës është i rregulluar mirë, fitimprurës dhe likuid. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është një agjenci e pavarur subjekt juridik publike me autorizim për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare dhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë. BQK-ja ka miratuar rregullat dhe rregulloret bankare në përputhje me Marrëveshjet e Bazelit dhe direktivat e BE-së.

Sinjale alarmi për PPP

Transaksionet me përdorim intensiv të parave të gatshme dhe transaksionet me vlera të larta janë një nga sinjalet më të shpeshtë të alarmit për PPP në kuadër të industrisë bankare, më saktësisht në nivelin e shërbimeve bankare me pakicë.

Nga ana tjetër, fshehtësia është një tjetër sinjal alarmi për PPP, posaçërisht në kuadër të shërbimeve bankare për korporata. Rekomandimi 9 i FATF-së thekson se vendet duhet të sigurohen që ligjet e fshehtësisë së institucioneve financiare nuk pengojnë zbatimin e rekomandimeve të FATF-së. Për më tepër, identifikimi i pronësisë përfituese, si dhe fshehja e fondeve përmes përdorimit të strukturave komplekse juridike, mund të supozojnë edhe një risk më të lartë të pastrimit të parave, së bashku me transaksionet e produkteve komplekse dhe PEP-të. Edhe natyra shpesh ndër-kufitare e këtyre transaksioneve posedon risqe shtesë.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, shërbimet bankare korrespondente janë një aktivitet me risk të lartë karakteristik për sektorin bankar, pasi mund të përfshijnë transaksione me vlerë të lartë dhe informacion të kufizuar në lidhje me dërguesin dhe burimet e fondeve, veçanërisht kur

ekzekutohen transaksione me banka që ndodhen në një juridiksion që nuk është në pajtueshmëri me rekomandimet ndërkombëtare për PPP.

Natyra, shkalla dhe kompleksiteti i bankave të shërbimeve me pakicë të Kosovës, i bëjnë ato të cenueshme në të gjitha fazat e procesit të PP-së dhe të cenueshëm nga FT-ja për shkak të funksionit të tyre qendror në kuadër të sistemit financiar.

Marrë parasysh se sektori bankar trajton shumicën dërrmuese të të gjitha transfereve ndërkombëtare që kalojnë nëpër sektorin financiar, ai është i ekspozuar natyrshëm ndaj PP/FT-së në nivel ndërkombëtar, si në hyrje ashtu edhe në dalje nga Kosova.


Në përgjithësi, sektori bankar ka PPP/KFT LFT të fortë, dhe në krahasim me vendet e tjera evropiane, bankat kosovare vendore zgjedhën një qasje me aversion ndaj risikut. Për shembull, bankat kombëtare në përgjithësi nuk u shërbejnë jorezidentëve.

KDK-ja dhe mbajtja e shënimeve zbatohen në mënyrë efektive për të gjithë klientët, duke zbatuar KDK-në e zgjeruar aty ku kërkohet, ndërkohë që zbatohen procedurat të forta dhe efektive për monitorimin e transaksioneve të klientëve për të zbuluar aktivitetet e pastrimit të parave.

Bankat depozituan raportuan 785 RTD në vitin 2019, një numër i arsyeshëm marrë parasysh përmasat e sektorit bankar. Për më tepër, Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës gjykon se cilësia e RTD-ve është e mirë.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave të Kosovës në sektorin bankar:

Tipologjia I




Një shtetas i huaj me qëndrim në Kosovë i ka përdorur llogaritë në banka lokale për të pastruar fonde të paligjshme. Këto fonde u transferuan nga një subjekt i huaj biznesi me qëllim të mospagimit të tatimeve tek autoritetet përkatëse tatimore.

Pasi transferit të fondeve të paligjshme, shtetasi i huaj A bëri tërheqje të shumëfishta parash nën pragun e raportimit duke ndjekur një model specifik (tërheqje ditore të parave në kartëmonedha prej 500 eurosh).

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Smurfing - tërheqje të shumëfishta dhe të njëpasnjëshme të parave të gatshme në kartëmonedha 500 euro. Nëse këto transaksione do të ishin bashkuar në një të vetëm, do të raportohesh tek autoritetet lokale. Përmes smurfing-ut kriminelët zakonisht i integrojnë fondet e pastruara në ekonomi.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Arsyetimi i transaksionit - subjekti A nuk kishte ndonjë histori të ofrimit të shërbimeve të konsulencës, dhe as nuk dukej se vlera e fondeve të transferuara të ishte në përpjesëtim me shërbimet që pretendonte se ofronte subjekti A.

Tipologjia II




Subjekti A pretendon se shet video përmes një Platformë Online jashtë shtetit. Qarkullimi nga platforma online transferohet në llogaritë bankare në Kosovë, si në llogaritë private ashtu edhe në ato të biznesit. Vetëm fondet e transferuara në llogarinë e biznesit deklarohen në ATK, ndërsa të hyrat prej 600,000 dollarësh amerikanë u transferuan në Kosovë me qëllim të shmangies së pagesës së tatimeve. Fondet e pastruara u tërhoqën dhe u përdorën për pagesa online.

Subjekti A ishte në të njëjtën kohë nën hetim nga Gjykata e Prishtinës.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacionet ndërkufitare - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme dhe ka gjasa të vendosin fonde në sistemin financiar në formën e parave të gatshme.
- Klient nën hetim penal - subjektet raportuese duhet t'i njohin dhe të ndihen të qetë me klientët që marrin dhe me të cilët bëjnë biznes. Duhet të bëhen shqyrtime periodike në mënyrë që subjektet raportuese të ndihen të qetë me klientët e tyre për aq kohë sa zgjat marrëdhënia e biznesit.
- Llogaritë private - për shkak të nivelit më të ulët të transparencës së këtyre produkteve, këto llogari ulin gjurmueshmërinë e fondeve.

Tipologjia III




Subjektet A dhe B kanë kryer depozita me para të gatshme me vlerë të lartë, në vlerë prej 1,210,000 eurosh. Këto fonde të depozituara në llogaritë në Kosovë më vonë u transferuan në një subjekt të huaj biznesi, të vendosur në të njëjtin juridiksion nga ku e kishin origjinën transferet ndërkombëtare. Fondet e depozituara në llogaritë personale në Kosovë ishin rezultat i aktiviteteve të para-portuara të biznesit në vendin e huaj.

Kriminelët kishin synim t'u shmangeshin tatimeve dhe t'i pastrojnë paratë në Kosovë, duke i integruar këto fonde në sistemin financiar pas transferimit të parave jashtë Kosovës.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Arsyetimi i transaksionit - raportohet se transferi ndërkombëtar është pagesë për mallra. Këto mallra nuk ishin raportuar kurrë se siguroheshin nga subjekti i biznesit. Nuk u mor asnjë mall ose shërbim për pagesën prej 1,351,000 eurosh, duke e bërë të qartë se subjektet A dhe B ishin të interesuar vetëm për transferimin e parave nga Kosova.

Tipologjia IV




Në llogarinë personale të personit A bëhen depozita të shumëfishta në para të gatshme me vlerë të lartë. Pas futjes së parave në sistemin bankar, subjekti A vazhdon t'i shtresojë fondet: nga njëra anë, kryen disa operacione brenda llogarisë së vet (p.sh. depozita me afat, lëvizja të parave të gatshme dhe transaksione hyrëse ndërmjet llogarive të ndryshme personale).

Nga ana tjetër, A përdor llogaritë e subjektit B për të siguruar shtresimin e mëtejshëm, duke e komplikuar kështu gjurmueshmërinë e fondeve. Nuk ka asnjë arsyetim logjik të transferit nga A për B pasi që "shlyerjet e kredisë" që pretendohen nga subjekti A nuk u paraprinë nga një emetim i kredisë nga subjekti B.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione me përdorim intensiv të parave të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme dhe ka gjasa të vendosin fonde në sistemin financiar në formën e parave të gatshme.
- Operacione që nuk kanë logjikë ekonomike/financiare - pasi vendosjes së parave kriminale në sistemin financiar, kriminelët janë të interesuar t'i shtresojnë në mënyrë që t'i bëjnë më pak të gjurmueshëm. Kjo arrihet duke kryer operacione të shumëfishta dhe duke i lëvizur fondet sa më shumë që të jetë e mundur, edhe nëse tarifat janë të larta dhe operacionet duket se nuk kanë logjikë.
- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.

Tipologjia V




Kompania X nuk ka pika shitjesh në Kosovë. Importon mallra që ruhen ose rieksporthen në kompaninë Z në të njëjtën ditë të importit. Kompania Z nuk ka shitore me pakicë dhe është regjistruar së fundmi. Duket se nuk ka transaksione legjitime të tregtisë ndërkombëtare, duke qenë se në këto operacione nuk përfshihet realisht asnjë mall. Kriminelët përdorin llogari bankare në Kosovë për t'i lëvizur fondet përtej kufijve.

Subjekti A merr një tarifë si ndërmjetës.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Arsyetimi i transaksionit - raportohet se transferet ndërkombëtarë janë pagesa për import/eksport të mallrave, por nuk u shkëmbye asnjë mall. Fondet e paligjshme e kishin origjinën në vendin X, u vendosën dhe u shtresuan në Kosovë, për t'u integruar përfundimisht në sistemin financiar të vendit X pasi u pastruan.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Tipologjia VI




Shtetasit e huaj A, B dhe C janë pronarë të bizneseve të tregtisë ndërkombëtare në Kosovë dhe përdorin llogari bankare lokale për të marrë dhe dërguar fonde jashtë vendit. Qarkullimi në llogaritë e biznesit nuk përputhet me deklaratat e import-eksportit.

Shtetasit e huaj dyshohet se janë përpjekur të pastrojnë fonde të paligjshme në Kosovë nga krimet e kryera në vendin X, me qëllim integrimin e këtyre fondeve në vendin Z.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Mospërputhja e çmimeve - transaksionet që përfshijnë tregtinë ndërkombëtare nuk përputhen me shumat e raportuara tek autoritetet lokale. Çmimet rriten me qëllimin për ta bërë të duket sikur fondet e paligjshme janë rezultat i operacioneve të ligjshme, siç është tregtia.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Tipologjia VII




Subjektet A dhe B depozituan kartëmonedha të shumta prej 50 eurosh, të cilat shtypen ndryshe, një strategji kjo e zbatuar nga institucionet bankare për të identifikuar paratë e vjedhura. Këta individë, pa ndonjë lidhje të dukshme mes tyre, bëjnë depozita në llogaritë e biznesit të hapura kohët e fundit për t'u dhënë këtyre fondeve një fasadë ligjshmërie (qarkullim që vjen nga aktivitetet e biznesit).

Këto fonde të paligjshme u tërhoqën më pas.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.
- Kartëmonedha të shënuara - institucionet financiare mund të jenë në gjendje t'i identifikojnë kartëmonedhat e lidhura me kriminelët. Këto shenja zakonisht nuk janë të dukshme me sy të lirë, por janë provuar të jenë efektive në pengimin e vendosjes së fondeve të paligjshme në sistemin financiar.

Tipologjia VIII



Llogaria e subjektit A nuk kreditohet nga veprimtaria e biznesit e subjektit të regjistruar kohët e fundit, por nga transferet ndërkombëtare, përmes një ndërmjetësi të vendosur në Kosovë, nga një subjekt i vendosur në një juridiksion me risk më të lartë. Në këtë rast, ndërmjetësi mban një marrëdhënie bankare korrespondente me bankën e subjektit A.

Këto fonde depozitohen më pas në një llogari të huaj bankare private nën emrin e subjektit A, ose tërhiqen.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Ndërmjetësimi - ndërmjetësit zakonisht përdoren për të siguruar shtresim shtesë në operacionet e kryera nga kriminelët. Për më tepër, kjo i distancon më shumë kriminelët nga fondet në transaksion, gjë që në fund të fundit vështirëson gjurmueshmërinë e fondeve.
- Juridiksione me risk më të lartë - transaksioni ndërkufitar mund të përfaqësojë një tregues të riskut të lartë pasi komplikon gjurmueshmërinë e fondeve. Nëse juridiksionet e përfshira janë me risk më të lartë, do të thotë se ato konsiderohen nga FATF si vende që nuk mund t'i trajtojnë në mënyrë efektive risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, atëherë kjo do të supozonte një risk shtesë. Institucionet duhet të jenë shumë vigjilente ndaj palëve të vendosura në këto juridiksione.
- Llogaritë private - për shkak të nivelit më të ulët të transparencës së këtyre produkteve, këto llogari ulin gjurmueshmërinë e fondeve.

Shërbimet bankare korrespondente

FFATF i përcakton shërbimet bankare korrespondente si ofrimin e shërbimeve bankare nga një bankë ("banka korrespondente") për një bankë tjetër ("banka respondente"). Bankave respondente mund t'u sigurohet një gamë e gjerë produktesh dhe shërbimesh nga banka korrespondente, megjithëse ky term nuk vlen për transaksione që bëhen vetëm një herë, pasi lidhet me transaksione të vazhdueshme ndërmjet institucioneve.

Standardet Ndërkombëtare nuk kërkojnë nga institucionet që të kryejnë NJKT për klientët e klientëve të tyre (NJKKT). Sidoqoftë, institucionet duhet të vendosin procedura për të zbuluar dhe reaguuar ndaj ndryshimeve në profilin e riskut të institucionit respondent.

Kur zbulohen shqetësime, institucioni korrespondent duhet t'i përcjellë me institucionin respondent duke bërë një kërkesë për informacion (KPI) për çdo transaksion të veçantë. Pas marrjes së informacionit, institucioni korrespondent duhet të vlerësojë nëse institucioni respondent mbetet brenda oreksit për risk. Nuk pritët të realizohet asnjë NJKKT në emër të institucionit korrespondent.

Për shkak të riskut të lartë për PP që përfaqësojnë shërbimet bankare korrespondente, institucionet bankare të Kosovës duhet të kenë vendosur procedura efektive të NJKT-së për t'i zbuluar institucionet të cilave bankat kosovare u ofrojnë shërbime bankare korrespondente. KDK-ja dhe shpeshësia e rishikimit duhet të përshtaten me riskun e klientit.

Sistemi financiar i Kosovës është i ndërtuar mbi 10 banka. Bankat përfaqësojnë një risk shumë të lartë të pastrimit të parave, dhe shërbimet bankare korrespondente janë një aktivitet që përfaqëson një risk të lartë brenda sistemit bankar. FATF ka nxjerrë një Udhëzim për shërbimet bankare korrespondente në tetor 2016 (vegza). Për më tepër, Wolfsberg Group, një asociacion i trembëdhjetë bankave globale që synon të adresojë risqet e krimit financiar, ka publikuar materiale për të mbështetur zbatimin e Kujdesit të Duhur për Shërbimet Bankare Korrespondente, përfshirë një pyetësor për PPP (vegza). Bankat e Kosovës mund t'i konsiderojnë këto materiale gjatë miratimit dhe rishikimit të procedurave për PPP.

KDK - Identifikimi dhe verifikimi

Rekomandimi 10 i FATF-së u bën thirrje subjekteve raportuese që të angazhohen në mënyrë aktive me klientët në mënyrë që ta kuptojnë plotësisht natyrën e biznesit për të cilin klienti po kërkon produktin dhe shërbimet e këtyre institucioneve, si dhe pronësinë përfituese, ndërkohë që janë në gjendje të identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e klientit. Për këtë qëllim, një nga sfidat është përshtatja e proceseve dhe procedurave të subjekteve raportuese për t'i shërbyer një shoqërie gjithnjë e më të digjitalizuar.

Sipas FATF-së, pagesat digjitale po rriten me rreth 12.7% në vit, dhe parashikohet të arrijnë në 726 miliardë transaksione vjetore deri në vitin 2020. Prandaj, teknologjitë e identitetit digjital (ID) po evoluojnë me shpejtësi, duke u zhvilluar kështu sistemet e identitetit digjital. Të kuptuarit e tyre është bërë thelbësor në zbatimin e një qasje të bazuar në risk, ndërkohë që përdoren sisteme të besueshme dhe të pavarur të identitetit digjital. Për këtë qëllim, qeveritë duhet të hartojnë udhëzime ose rregullore të qarta që u lejojnë subjekteve të rregulluara ta realizojnë siç duhet KDK-në sipas një qasje të bazuar në risk.

Subjektet e rregulluara, nga ana tjetër, duhet:

- Të përdorin një qasje të informuar dhe të bazuar në risk për t'u mbështetur në sistemet e identitetit digjital për KDK, duke përfshirë të kuptuarit e nivelit të sigurimit të sistemit, veçanërisht për vërtetimin dhe autentifikimin e identitetit, dhe duke siguruar që nivelet e sigurimit janë të përshtatshme për risqet për PP/FT të lidhura me klientin, produktin dhe juridiksionin;
- T'i kuptojnë komponentët themelorë të sistemeve të identitetit digjital, veçanërisht për vërtetimin e identitetit dhe identifikimin;
- Të konsiderojnë sistemet e identifikimit digjital për Kujdesin e Duhur të thjeshtuar për klientët me risk më të ulët, ndërkohë që adoptojnë një qasje me nivele për shfrytëzimin e sistemeve digjitale në nivele të tjera sigurie për të mbështetur përfshirjen financiare;
- Të shqyrtojnë politikat për të rivekurësuar nevojën për ta klasifikuar identifikimin jo sy më sy të klientëve si një aktivitet me risk të lartë;
- Kur është relevante, të përdorin proceset kundër mashtrimit dhe të sigurisë kibernetike për të mbështetur vërtetimin dhe autentifikimin e

identitetit digjital;

- Subjektet e rregulluara duhet të sigurohen që të kenë qasje ose të kenë një proces për t'u mundësuar autoriteteve të marrin informacionin themelor të identitetit dhe provat ose informacionin digjital të nevojshëm për identifikimin dhe verifikimin e individëve.

Për më shumë informacion mbi identitetin digjital, FATF ka publikuar një konsultim publik për këtë çështje (vegza), në bazë të të cilit janë hartuar komentet e mëparshme. Duhet të theksohet se Udhëzimi është ende duke u punuar dhe prandaj përmbajtja mund të ndryshohet.

Produkte dhe shërbime komplekse

Në këtë abstrakt duhet të konsiderohen edhe metodat e reja të pagesës dhe monedhat virtuale. Asetet virtuale kanë krijuar një ekosistem të prirur për të rritur anonimitetin, ndërsa platformat dhe shkëmbyesit janë bërë gjithnjë e më të decentralizuar, duke mundësuar uljen e transparencës dhe rritjen e maskimit të flukseve financiare, si dhe shfaqjen e modeleve të tjera të biznesit të aseteve virtuale, si ofertat e monedhave, që përfaqësojnë risqe për PP/TF, përfshirë risqe të mashtrimit dhe manipulimit të tregut.

Për më tepër, vazhdojnë të shfaqen tipologji të reja të financimit të paligjshëm, duke përfshirë përdorimin në rritje të skemave të shtresimit virtual-virtual. FATF ka publikuar një Udhëzim mbi Asetet Virtuale dhe Ofruesit e Shërbimeve të Aseteve Virtuale (vegza).

Rekomandime dhe hapat vijues

Edhe pse Kosova nuk është pjesë e Eurozonës, vendi ka adoptuar euron si monedhën e vet. Kjo ka rritur stabilitetin financiar brenda territorit dhe i ka lejuar juridiksionit të mbetet tërheqës për investitorët e huaj dhe vendas. Për më tepër, stabiliteti i euros e ka mbrojtur Kosovën nga risqet e zhvlerësimit, gjë që ka mundësuar rritjen ekonomike dhe shtimin e të hyrave mesatare të amvisërive.

Bankat pritet të vazhdojnë mbështetjen e tyre për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes zgjerimit të kredisë. Kjo do të rrisë sasinë e kredive në ekonomi, çka do të lejojë që kriminelët t'i kamuflojnë më lehtë kreditë fiktive.

Sipas Emerging Europe, një agjenci e gazetarisë, në fund të vitit 2018 kreditë në proces të shlyerjes arritën në 2.7 miliardë euro, krahasuar me 1.4 miliardë në vitin 2010, çka përfaqëson një rritje prej 93%. Në të njëjtën kohë, depozitat u rritën me 73% gjatë së njëjtës periudhë, duke arritur në 3.36 miliardë euro në 2018.

Kreditimi prej kriminelëve iparavetë tyre kriminale pritet të mbetet një nga format e kredive "të fabrikuara" më të përdorura. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të forco-

hen përpjekjet për t'i kuptuar këto produkte dhe për ta kryer me efektivitet Kujdesin e Duhur të Klientit me qëllim identifikimin e transaksioneve që nuk kanë asnjë arsytim.

Natyra me përdorim intensiv të parave të gatshme e ekonomisë së Kosovës do të mbetet një pengesë në të ardhmen e afërt për sigurimin e plotë të produkteve të financimit nga bankat. Për sa kohë që të punësuarit vazhdojnë të paguhen në para të gatshme, ata nuk do të kenë mundësi për qasje në instrumentet e kreditimit nga bankat. Zhvillimi i instrumenteve të mikrofinancimit dhe pagesave digjitale, si dhe përdorimi më i shpeshtë i kartelave të kreditit do ta rrisë përmasat e ekonomisë formale, çka përfundimisht do t'i zgjerojë shërbimet bankare me pakicë.

Kosova do të përjetojë edhe një zhvillim dhe zgjerim më të fortë të pagesave digjitale, të cilat do të kenë një ndikim të madh në sistemin bankar. Subjektet bankare do t'i përfshijnë këto produkte, si dhe do t'iu duhet të përshtatin politikat dhe procedurat e tyre aktuale për t'i shërbyer një popullate që gjithnjë e më shumë ka nevojë për shërbime digjitale, duke qenë në pajtueshmëri me kërkesat ndaj pastrimit të parave. Një nga sfidat më të mëdha do të mbetet mungesa e identifikimit dhe verifikimit sy më sy të identitetit të klientëve.

Mikrofinancimi

Mikrofinancimi, i referuar shpesh si “shërbime bankare për ata që janë jashtë bankave” ose si përfshirje financiare, është një aktivitet që përfshin aktivitete financiare që synojnë t’u mundësojnë më shumë individëve dhe bizneseve, veçanërisht grupe me të hyra të ulëta, rurale, pa shërbime dhe shërbime të pamjaftueshme, të kenë qasje dhe të përdorin shërbime zyrtare financiare.

Përveç bankave tregtare, Institucionet Mikrofinanciare (IMF) përfaqësojnë një faktor tjetër të rëndësishëm në tregun e huadhënies në Kosovë. Vlera totale e asetëve të IMF-ve arriti në 192.4 milionë euro në vitin 2017. Përfituesit kryesorë të kredive të IMF-ve janë amvisëritë (64% qind e vlerës së kredive) dhe ndërmarrjet e vogla (36% qind e vlerës së kredive). Përmasa mesatare e kredive është përafërsisht 2,000 euro.

Sinjale alarmi për PPP

Promovimi i migrimit të popullatës nga shërbimet financiare informale në ato formale është thelbësore për agjendat për PPP. Një ekonomi nëntokësore mund të jetë një kanal për transaksione të paligjshme. Sidoqoftë, mikrofinancimi është i cenueshëm ndaj risqeve të PP, përkatësisht nga mungesa e dokumentacionit të besueshëm të identitetit dhe verifikimit të të dhënave për klientët potencialë, çka nga ana tjetër kufizon aftësinë e institucioneve që të realizojnë nivelet e kërkuara të kujdesit të duhur. Kjo mungesë e dokumentacionit zakonisht është e dukshme tek personat që jetojnë në zona rurale ose të punësuar në sektorin informal (shpesh herë individë të paguar në para të gatshme dhe/ose migrantë pa dokumente).


Duhet të theksohet se individët e përjashtuar financiarisht veprojnë pothuajse tërësisht me para të gatshme. Prandaj, transaksionet do të jenë të vështira për t’u gjurmuar dhe sigurimi i dokumentacionit mbi burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve mund të kthehet në sfidë. Qeveria, së bashku me subjektet raportuese, duhet të punojnë për t’i dalluar ato operacione të lidhura me evazionin tatimor (që përdorin pra sektorin e mikrofinancimit për të pastruar para), nga ato operacione ose klientë që po

përpiqen të futen në komunitetin e mbuluar nga bankat në Kosovë.

Në përgjithësi, kompanitë mikrofinanciare duket se kanë njohuri më të dobëta në lidhje me PPP/KFT, çka ilustruhet pjesërisht nga paraqitja e RTD-ve prej tyre. Për më tepër, duke qenë se këto janë kompani kredituese, ato kanë arsye të forta për ta identifikuar klientin dhe për të mbajtur shënime të mira. Kompanitë mikrofinanciare zakonisht kanë një njohuri të mirë të bazës së tyre të klientëve të ndërtuar gjatë periudhave më të gjata kohore, çka e bën më të lehtë të zbulohen sjellje të dyshimta.

Tipologjia e mëposhtme ilustron disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e mikrofinancimit:

Tipologjia IX



Shtetasi i huaj A ka hapur një llogari biznesi në Kosovë dhe filloi të bënte depozita në para të gatshme të pasuara nga transfere të menjëhershme ndërkombëtare (që përshkruhen si “pagesë e faturave”) për një kompani të huaj.

Falë bashkëpunimit ndërkombëtar u vërtetua se subjekti A nuk është i regjistruar në vendin e origjinës, që do të thotë se llogaria është hapur me dokumentacion të rremë.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t’u nënshtrohen analizave.
- Identifikimi dhe verifikimi i klientëve - individët që paraqesin dokumentacionin e falsifikuar ose të palës së tretë përfaqësojnë një risk të lartë pasi nuk duan të shpalosin identitetin e tyre të vërtetë. Subjektet raportuese duhet të kenë vendosur mekanizma të ndryshëm për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e klientëve.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Transaksionet dhe transporti i parave të gatshme

Përkundër prevalencës në rritje të metodeve të pagesës jo në para të gatshme në ekonominë e zhvilluara, paratë e gatshme mbeten një mjet i rëndësishëm i shlyerjes në mbarë botën, duke u përdorur edhe në ekonominë kriminale. Përdorimi i parave fizike i distancon fitimet nga krimi nga vepra penale bazë që i ka gjeneruar, duke i prishur gjurmët e auditimit. Kështu, kriminelët normalisht do të preferonin të kompensoheshin në para të gatshme, çka justifikon nevojën për një vetëdijesim të shtuar në lidhje me klientët me përdorim intensiv të parave të gatshme, si në kuadër të institucioneve financiare ashtu edhe të BPPJF-ve.

Monedha kombëtare e Kosovës është euro, çka i rrit risqet që institucionet kombëtare të bëhen një mjet për pastrimin e parave kriminale. Monedhat që përdoren më shpesh nga kriminelët janë më të tregtueshmet, të qëndrueshmet dhe të përdorura gjerësisht, si dollari amerikan, funta britanike dhe franga zvicerane.

Kriminelët shpesh duhet të përdorin një pjesë të konsiderueshme të parave të gatshme që kanë fituar për të paguar mallrat e paligjshme që kanë shitur, për

të blerë dërgesa të mëtejshme ose për të paguar shpenzimet e ndryshme të bëra gjatë transportimit të mallrave atje ku kërkohen. Sa më të suksesshëm të jenë kriminelët dhe sa më shumë mall shesin, aq më shumë para të gatshme do të gjenerojnë. Kjo mund t'u shkaktojë kriminelëve probleme të rëndësishme në përdorimin, ruajtjen dhe disponimin e fitimeve të tyre. Megjithatë, përkundër këtyre problemeve, paratë e gatshme perceptohen se u japin atyre përfitime të konsiderueshme.

Mbajtja ose lëvizja e shumave të mëdha të parave të gatshme pa sqarim mbi origjinën apo qëllimin e tyre është bërë gjithnjë e më e vështirë për kriminelët dhe grupet kriminale si rezultat i përpjekjeve ndërkombëtare për përvetësimin e Rekomandimeve 10, 11 dhe 20 të FATF-së (vegza) në lidhje me Kujdesin e Duhur ndaj Klientëve dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta (RTD). Në përputhje me rrethanat, kriminelët përpiqen t'u shmangen çështjeve të tilla duke i mbajtur paratë e gatshme të gjeneruara, dhe nëse kërkohen diku tjetër, thjesht i lëvizin paratë fizike përmes kufijve ndërkombëtarë. Për më tepër, në territoret ku sistemi i rregullt financiar është çrregulluar për shkak të konflikteve, të gjitha llojet e personave do të përpiqen t'i transfero-

jnë asetet e tyre në juridiksione të tjera. Në shumë raste, edhe kur fitimet nga një krim fillimisht gjenerohen në formë elektronike (siç është vjedhja e fondeve nga një llogari bankare), kriminelët zgjedhin t'i tërheqin fondet nga llogaria e një institucioni financiar në para të gatshme, duke i transportuar në një vend tjetër, dhe i paguajnë në një llogari tjetër në mënyrë që të priset gjurma e auditimit. Për këtë qëllim, FATF ka publikuar një udhëzim mbi Transportin Fizik të Parave të gatshme (vegza).

Rekomandim dhe hapat vijues

Sipas Emerging Europe, rreth 52% e të rriturve në Kosovë aktualisht kanë një llogari bankare, duke qëndruar më shumë se 20 pikë nën Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut. Interesi i Kosovës për një integrim më të lartë ekonomik dhe financiar për pjesën tjetër të rajonit dhe Evropës do të duhet të shoqërohet me një përfshirje më të lartë financiare.

Përpyekjet për të ulur numrin e individëve jashtë bankave në Kosovë përfundimisht mund të ndikojnë në përmasat e tregut të industrive të mikrofinancimit. Kjo do të shtyhet gjithnjë e më shumë nga popullata e re në moshë e interesuar në shërbime bankare online dhe mobile.

Ndërkohë, kompanitë e mikrofinancimit dhe subjektet qeveritare do të duhet të rritin përpjekjet e tyre për ofrimin e zgjidhjeve financiare për segmentet e popullatës që mund të mos posedojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar për të operuar. Sfida do të jetë adaptimi i mekanizmave dhe politikave për të përfshirë sa më shumë njerëz të jetë e mundur, pa rritur ekspozimin e Kosovës ndaj risqeve të pastrimit të parave.

Sigurimi i jetës

Produktet e sigurimit të jetës janë kontrata të dizajnuara kryesisht për ta mbrojtur financiarisht klientin/mbajtësin e policës dhe palët e treta të lidhura me të (i siguruar, përfituesit dhe pronarët përfitues të kontratës) kundër riskut të një ngjarje të pasigurt në të ardhmen (d.m.th. vdekje ose sëmundje kritike). Shumica e këtyre produkteve janë dizajnuar për një afat të gjatë dhe disa do të paguajnë vetëm për ndodhinë e një ngjarje të verifikueshme. Sidoqoftë, disa nga këto produkte kanë karakteristika kursimi ose investimi, të cilat mund të përfshijnë opsionet për tërheqje ose dorëzim të plotë dhe/ose të pjesshëm në çdo kohë.

Aktualisht ka 15 kompani të sigurimeve të licencuara (përfshirë 3 kompani që ofrojnë sigurimin e jetës) në kuadër të sektorit të sigurimeve, duke përfaqësuar rreth 3% të totalit të aseteve të sistemit financiar. Në vitin 2017, përmasa e aseteve të sektorit arriti në 176.8 milionë euro. Sigurimi jo i jetës ka peshën më të lartë në totalin e aseteve të sektorit (afërsisht 87.8%).

Sinjale alarmi për PPP

Risqet që lidhen me këtë produkt janë më të ulëta se ato që lidhen me produkte të tjera financiare, siç janë kreditë dhe shërbimet e pagesave, ose sektorë si ai bankar dhe i tregtarëve të gurëve dhe metaleve tëçmuar. Produktet e sigurimit të jetës nuk janë aq fleksibël sa të jenë instrumenti i preferuar për pastruesit e parave. Sidoqoftë, ekziston risku që fondet e përdorura për blerjen e sigurimit të jetës të kenë një prejardhje kriminale.


Disa kompani të sigurimit të jetës mund të përfshihen në ofrimin e shërbimeve të administrimit të pasurisë dhe/ose produkteve të investimeve, të cilat tradicionalisht supozojnë një risk të lartë të pastrimit të parave.

Për më tepër, karakteristikat e mëposhtme të produktit mund të rrisin risqet e pastrimit të parave të shërbimeve të sigurimit të jetës: maturimi më i shkurtër, produkte shumë likuide pa tarifë për tërheqjen e parakohshme, produkte jo sy më sy dhe produkte që lejojnë pagesa të larta/të pakufizuara të primit, mbipagesa, ose vëltime të mëdha të pagesave të primit me vlerë më të ulët.

Ngjashëm me sektorët e tjerë, sigurimi i jetës mund të përballet edhe me riskun e lidhur me operacionet me para të gatshme. Për shkak të niveleve të larta të parave të gatshme brenda shoqërisë, kompanitë mund t'i pranojnë si mjet pagese.

Tipologjia e mëposhtme ilustron disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e sigurimit të jetës:

Tipologjia X




Një subjekt i sigurimit të jetës në Kosovë nuk raporton transaksione të dyshimta të lidhura me shuma të mëdha të fondëve hyrëse që përfshijnë riatdhesimin e fondëve potencialisht të lidhura me shkeljet tatimore.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Burimi i paqartë i fondëve - subjektet raportuese duhet të bëjnë çmos për njohjen e klientit dhe që ta kuptojnë burimin e tij të fondëve.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondëve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondëve kriminale.

Tipologjia XI



Një kontratë e sigurimit të jetës për 50,000 euro për 30 vjet, e negociuar nga subjekti ndërmjetësues me kompaninë e sigurimit të jetës. Subjekti A pyeti nëse është e mundur të merret përsipër ose të anulohet kontrata.

Kontrata standarde e sigurimit të jetës përmbante një klauzolë që lejonte shlyerjen pas 4 vjetësh. Subjekti A kërkoi një shmangie nga kjo klauzolë për të lejuar që periudha e shlyerjes të fillojë pas 2 vjetësh.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Shlyerja e parakohshme - mundëson që fondet e marra përmes krimit t'i paguhen një kompanie të sigurimeve, direkt ose përmes një ndërmjetësi. Pasi të bëhet shlyerja e policës, personi në fjalë ka fonde nga një kompani e sigurimeve që mund të vendosen në sistemin kryesor financiar.

Rekomandim dhe hapat vijues

Tregu i sigurimit të jetës është i vogël në krahasim me të tjerë në sektorin financiar, por është gjithashtu në fazat fillestare dhe ka gjasa të rritet në vitet e ardhshme.

Me plakjen e popullatës, shumë vende po përpiqen t'i inkurajojnë skemat e kursimeve, përfshirë produktet e sigurimit të jetës dhe pensione. Është një veçori e skemave të tilla që pagesat në para të gatshme shpesh pranohen si pagesa të primit ose kontributeve. Kjo mund të ndodhë veçanërisht në juridiksione si Kosova, ku paratë e gatshme janë ende mjeti kryesor për kryerjen e pagesave të vogla ose të rregullta.

Ndërkohë që ekonomia bëhet gjithnjë e më e digjitalizuar, ekspozimi i saj ndaj parave të gatshme mund të ulet. Ndërkohë, me rritjen e operacioneve të sigurimit të jetës, mund të përhapen edhe ndërmjetësit.

Duke qenë se ndërmjetësit mund të tregtojnë produkte të tjera financiare, siç janë produktet e investimeve dhe hipotekat dhe kanë kontakt sy më sy me klientët, ata mund të bëhen përgjegjës për kryerjen e KDK-së.

Mund të vlejë të theksohet se zakonisht-

gjatë riatdhesimit të aseteve vendosen programe të pajtueshmërisë vullnetare tatimore ose stimuj të amnistisë tatimore. Këto programe mund të rrisin risqet sektoriale të pastrimit të parave. Subjektet raportuese dhe organet qeveritare duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë elementeve të mashtrimit të lidhur me tatimet gjatë shqyrtimit dhe zbatimit të veprimeve ose sanksioneve përmbartimore.

Fondet pensionale

Fondet pensionale sigurojnë benefite pensionale për të punësuarit, ku kontributet paguhen nga të punësuarit, punëdhënësit, ose të dy. Në të njëjtën kohë, menaxherët e Fondit i investojnë këto para të mbledhura.

Janë dy fonde pensionale në veprim, përkatësisht Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) me një mandat eksklusiv për të administruar kontributet e detyrueshme pensionale; dhe Fondi Sllloven-Kosovar i Pensioneve (FSKP) që administrojnë vetëm fondet e pensionit vullnetar.

Ky është sektori i dytë më i madh në sektorin financiar, me 27.9% të totalit të aseteve financiare, prej të cilëve mbi 99.5% administrohen nga FSKP-ja.

Sinjale alarmi për PPP

Cenueshmëritë e pensioneve janë të ngjashme me ato të sigurimit të jetës. Këto fonde zakonisht nuk supozojnë një risk të lartë për PPP pasi që të gjitha transaksionet bëhen domosdoshmërisht përmes sektorit bankar dhe fondet mund të merren vetëm pasi pala tjetër të arrijë moshën e pensionit.

Sidoqoftë, sa herë që fondet pensionale ofrojnë produkte të menaxhimit të pasurisë/investimeve, risqet e pastrimit të parave mund të rriten.

Cenueshmëritë kryesore të fondeve pensionale kanë të bëjnë me përmasat dhe karakteristikat e popullatës së Kosovës, që ka gjasa të përfshijë PEP dhe klientë të tjerë me risk të lartë. Megjithatë, 99.5 për qind e kontributeve lidhen me kontributin e detyrueshëm.

Nga subjektet raportuese nuk është përshkallëzuar asnjë tipologji e pastrimit të parave në lidhje me fondet pensionale. Si qeveria ashtu edhe subjektet raportuese mbeten vigjilente ndaj risqeve dhe cenueshmërive të këtij sektori, ndërkohë që përvetësojnë rekomandimin dhe praktikat më të mira.

Rekomandim dhe hapat vijues

Sektori nuk është tërheqës për kriminelët e interesuar për të pastruar fitimet e tyre të paligjshme.

Megjithatë, në juridiksione të tjera janë vërejtur treguesit e mëposhtëm që duhet të konsiderohen nga autoritetet kombëtare:

- Depozita të mëdha parash të gatshme në skemat pensionale nga anëtarët e skemës;
- Depozita të letrave me vlerë ose asete të tjera që nuk kanë asnjë logjikë për profilin e klientit dhe burimin e fondeve/pasurisë;
- Transferimi i aseteve në një skemë kapitalizimi nga një palë e tretë e palidhur;
- Palë të treta të palidhura paguajnë kontribute në para të gatshme në emër të anëtarëve të skemës pensionale;
- Person i papunë që paguan kontribute në një skemë pensionale.

Shërbimet e transfereve të parave ose vlerave

Shërbimet e transfereve të parave ose vlerave (ShTPV) përfshijnë pranimin e parave të gatshme, çeqeve, instrumenteve të tjera monetare ose depozitimin e vlerave dhe pagimin e një shume korresponduese në para të gatshme ose formë tjetër për përfituesin me anë të një komunikimi, mesazhi, transferi ose përmes një rrjeti të aprovimit. Ndër të tjera, këto shërbime mund të emërtohen edhe "hawala", "hundi" dhe "fei-chen".

Disa nga karakteristikat kryesore të këtyre shërbimeve janë:

- Kosto më e ulët dhe mundësi më e shpejtë për të dërguar para (në krahasim me transferet e brendshme ose ndërkombëtare që mund të kërkojnë disa ditë për t'u përpunuar);
- Shpesh janë të pranishme në rajone me mbulim të kufizuar në shërbime jobankare;
- ShTPV-të mund të jenë në strukturën e një institucioni bankar, ose jo. Në kuadër të këtij modeli të fundit, përmasat dhe kompleksiteti i ofruesve ndryshojnë, pasi ato mund të përfshijnë zyrat postare, institucio-

net mikrofinanciare, operatorët e rrjetit mobil, zyrat e këmbimit, institucionet e pagesave, shërbimet e llogarive të ruajtjes, shërbime të pagesave të faturave dhe pagesave digjitale.

Ngjashëm me subjektet mikrofinanciare, ShTPV-të luajnë rol në agjendën e përfshirjes financiare në Kosovë. Në këtë drejtim, remitancat janë një shërbim i rëndësishëm financiar për qytetarët në shumë vende në zhvillim dhe janë një mundësi i fuqishëm i përfshirjes financiare. Këto janë një burim i rëndësishëm i të hyrave për të paktën 43% të popullsisë së Kosovës, duke përfaqësuar rreth 15 për qind të BPV-së (ose gati 1 miliard euro) në vitin 2017. Shumica e remitancave vijnë nga diaspora kosovare në vendet evropiane, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër. Banka Qendrore raporton se remitancat kryesisht përdoren për konsum personal, jo për qëllime investimi.

Aktualisht, ka 5 Biznese të Shërbimeve Monetare në Kosovë. Firmat e remitancave të parave janë veçanërisht tërheqëse pasi ato zakonisht janë më të qasshme se subjektet e tjera financiare. Për shembull, përdoruesit mund të mos kenë nevojë të hapin një llogari dhe transferi zakonisht kryhet brenda disa minutash.

Sinjale alarmi për PPP


Në kuadër të tregut të ofruesve të ShTPV-ve jobankare, përmasat dhe kompleksiteti i ofruesve ndryshojnë ndjeshëm, dhe janë përshtatur modele të ndryshme biznesi. Ofruesit mund të përfshijnë ofruesit ndërkombëtarë të ShTPV-së, zyrat postare, institucionet e mikrofinancimit, operatorët e rrjetit mobil, zyrat e këmbimit, institucionet e pagesave, shërbimet e llogaritë të ruajtjes, shërbime të pagesave të faturave dhe TI-së dhe pagesave digjitale dhe operatorët e transfereve të parave. Ofruesit e shërbimeve ShTPV zakonisht specializohen përgjatë linjave me pakicë, komerciale dhe me shumicë.

Ngjashëm me sektorët e tjerë në ekonominë kosovare, ShTPV-të janë të ekspozuar ndaj transaksioneve me përdorim intensiv të parave të gatshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë për këto subjekte, pasi ato zakonisht janë zgjedhja e parë për remitancat ndërkombëtare. Marrë parasysh sasinë e madhe të operacioneve në para të gatshme, kriminelët mund ta kenë më të lehtë të veprojnë brenda këtij sektori pa u raportuar. Duke konsideruar këtë objektiv, kriminelët zakonisht i strukturojnë operacionet në para të gatshme në shumica të ngjashme nën pragun e raportimit.

Remitancat ndërkombëtare i referohen edhe natyrës ndërkufitare të këtyre produkteve, çka i rrit risqet e pastrimit të parave, duke qenë se gjurmimi i parave bëhet më i ndërlikuar. Ato remitanca që kanë një natyrë ndërkombëtare supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e shërbimeve të transferimit të vlerave:

Tipologjia XII




Subjekti A mori një vëllim të lartë të transaksioneve me vlerë të ulët (mesatarisht 100 euro secili) nga 50 vende të ndryshme. Këto transaksione arritën në 55,000 euro. Subjekti A nuk kishte llogari bankare në Kosovë, duke qenë se të gjitha veprimet e veta i kreu përmes institucioneve të Shërbimeve të Transfereve të Parave.

Subjekti A raportohet të ketë rekorde të shumta kriminale dhe është i përfshirë në më shumë se 15 raste me Policinë e Kosovës, duke përfshirë dyshime për përdhunim, mashtrim, plaçkitje, armëmbajtje të paligjshme, prishje të rendit dhe qetësisë, si dhe dyshohet për ndihmë dhe favorizim të prostitucionit.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Burimi i paqartë i fondeve - subjektet raportuese duhet të bëjnë çmos për njohjen e klientit dhe që ta kuptojnë burimin e tij të fondeve.
- Klient nën hetim penal - subjektet raportuese duhet t'i njohin dhe të ndihen të qetë me klientët që marrin dhe me të cilët bëjnë biznes.

Tipologjia XIII



Kompania ABC, me bashkëpunimin e një subjekti të huaj të biznesit, dyshohet se ka pastruar para që vijnë si rezultat i tregtisë së padrejtë në vendin Z.

Subjekti i biznesit është gjithashtu i vendosur në vendin Z. Fondet e paligjshme dyshohet se janë futur në sistemin financiar të Kosovës përmes sistemit bankar, si dhe përmes një institucioni të Shërbimeve të Transfereve të Parave. Pasi paratë vendosen në sistemin financiar, ato shtresohen përmes një llogarie personale të subjektit përmes operacioneve të ndryshme si depozitat me afat dhe investimet. Më në fund, paratë e paligjshme integrohen në sistemin financiar përmes tërheqjeve të parave të gatshme.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Çmime të padrejta - subjekti i huaj i biznesit është angazhuar në aktivitete mashtruese duke i kërkuar klientit çmime më të larta se tregu.
- Operacione ndërkuftare - transaksionet ndërkuftare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Operacione që nuk kanë logjikë ekonomike/financiare - pasi vendosjes së parave kriminale në sistemin financiar, kriminelët janë të interesuar t'i shtresojnë në mënyrë që t'i bëjnë më pak të gjurmueshëm. Kjo arrihet duke kryer operacione të shumfishta dhe duke i lëvizur fondet sa më shumë që të jetë e mundur, edhe nëse tarifat janë të larta dhe operacionet duket se nuk kanë logjikë.

Transaksione ndërkufitare

Operacionet ndërkufitare mund të paraqesin risqe shtesë të pastrimit të parave për dy arsye. Nga njëra anë, natyra e tyre ndërkombëtare shton një shtresë shtesë në operacion, ndërsa gjurmimi i fondeve mund të bëhet më i vështirë. Nga ana tjetër, nëse juridiksionet e përfshira në transaksionin ndërkufitar konsiderohen nga FATF si “me risk më të lartë” ose “të monitoruara”*, institucionet që mbajnë marrëdhënie me klientin do të rritnin ekspozimin e tyre ndaj risqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Masat mbrojtëse globale për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (PPP/KFT) janë po aq të forta sa juridiksioni me masat më të dobëta. Kriminelët mund t'i anashkalojnë kontrollet e dobëta PPP/KFT për t'i pastruar me sukses paratë ose për t'i lëvizur asetet për të financuar terrorizmin përmes sistemit financiar.

Rekomandimi 19 i FATF-së i nxit institucionet financiare të zbatojnë masa të kujdesit të duhur të zgjeruar për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet që përfshijnë vendet me risk më të lartë. Lloji i kujdesit të duhur të zgjeruar duhet të jetë efektiv dhe në përpjesëtim me risqet.

*Juridiksionet “me risk më të lartë” ose “të monitoruara” janë vendet që FATF i ka identifikuar me mangësi strategjike në kornizat e tyre për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për të kontrolluar listën e juridiksioneve për të cilat aplikohet Thirrja për veprim e FATF-së dhe juridiksione të tjera të monitoruara, klikoni në vegza.

Rekomandime dhe hapat vijues

Të gjithë remituesit e parave që veprojnë në Kosovë janë kompani më të mëdha ndërkombëtare (Western Union është dukshëm më i madhi në Kosovë) që e zbatojnë globalisht politikën e tyre PPP/KFT.

Transmetuesit e parave kanë programe efektive për PPP/KFT dhe ndihmojnë në parandalimin e pastrimit të parave duke paraqitur në kohë RTD që sinjalizojnë për strukturimin dhe aktivitete të tjera të dyshimta. Teksa sektori kishte depozituar përafërsisht 15% të të gjithë RTD-ve në periudhën 2014-2017, shumica dërrmuese e tyre ishin dorëzuar nga 2 kompanitë më të mëdha të remitancave.

Detyrimet e regjistrimit kërkojnë që emetuesit dhe shitësit e urdhrave të parave të verifikojnë dhe të regjistrojnë identifikimin e klientëve për të gjitha urdhër pagesat në para të gatshme, megjithatë kjo nuk përfshin KDK-në e zgjeruar për klientët me risk të lartë si PEP. Prandaj, fitimet e paligjshme që rrjedhin nga sjellja korruptive nga zyrtarët e qeverisë së Kosovës mund të konstatohen lehtësisht përmes këtyre institucioneve. Subjektet raportuese dhe organet qeveritare duhet të vlerësojnë vendosjen e procedurave për PEP-të.

Institucionet kombëtare duhet të punojnë së bashku për të adresuar aktivitetin ndërkufitar dhe modelet e biznesit vetëm digjital, shoqëruar me trajnime të përditësuara për nëpunësit civilë, si dhe për sektorin privat dhe të tretë.

Ofruesit e këmbimit të monedhës

Tregtarët e këmbimit të monedhës (ose zyrat e këmbimit të monedhave) janë biznese ku njerëzit mund të këmbejnë një monedhë për një tjetër.

Aktualisht ekzistojnë 41 zyra të këmbimit të monedhës në Kosovë, të cilat trajtojnë kryesisht transaksione të vogla që lidhen me shpenzimet personale, p.sh. turistë ose persona që udhëtojnë jashtë vendit.

Sinjale alarmi për PPP

Marrë parasysh shumëllojshmërinë e produkteve dhe gamën e kanaleve të shpërndarjes që zakonisht ofrojnë këto biznese, shpejtësinë e lartë të transferit dhe faktin që këto biznese janë zakonisht me përdorim intensiv të parave të gatshme, ofruesit e këmbimit të monedhës konsiderohen me risk të lartë.

Për më tepër, këto biznese shpesh kërkojnë rregulla më pak të rrepta të identifikimit të klientit dhe kontakti me klientët është zakonisht i shkurtër.


Ngjashëm me ofruesit e shërbimit të parave, strukturimi ose "smurfing" raportohet shpesh dhe duket se mbetet një nga metodat më të zakonshme të pastrimit të parave në shumë vende. Këto transaksione mund të kryhen ose brenda një dite të vetme ose gjatë një periudhe ditësh, përmes agjentëve të njëjtë ose disa të ndryshëm.

Veçanërisht, risqet që lidhen me këtë sektor nuk përfshijnë vetëm keqpërdorimin e këmbimit të monedhës për pastrim parash, por edhe mbajtjen e bizneseve të tilla nga grupe kriminale dhe të punësuar të korruptuar që bashkëpunojnë me kriminelë.

Në shumicën e vendeve kërkohet një licencë për t'i administruar këto lloje biznesesh, dhe këto licenca zakonisht jepen nga Banka Qendrore.

Tipologjia e mëposhtme ilustron disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e ofruesve të këmbimit të monedhës:

Tipologjia XIV




Subjektet A, B, C dërguan/morën një numër të madh të remitan-cave për/nga persona dhe destinacione të ndryshme (shpesh në një numër të vendeve të huaja) gjatë një periudhe të shkurtër kohore. Shuma totale e remitan-cave të marra dhe të dërguara ishte pothuajse e barabartë, dhe personat deklaruan se i njihnin personat që ishin përfitues të transfereve të porositura prej tyre. Transferet u bënë në disa monedha.

Hetimi zbuloi se shumë nga personat e huaj të përfshirë në skemë kishin sfond kriminal.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione të këmbimit të monedhës - këto operacione kontribuojnë në shtresimin e fondeve.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Tipologjia XV



Subjekti A mban rubla që vijnë nga operacionet e paligjshme në Rusi. Këto fonde depozitohen më pas në një ofruer të këmbimit të monedhës në Kosovë dhe këmbehen në euro.

Më vonë, këto fonde këmbehen në dollarë amerikanë. Kryerja e këmbimeve të shumëfishta të monedhave nuk ka kuptim ekonomik për shkak të tarifave të paguara, por subjekti A ishte i interesuar për shtresimin e fondeve dhe vështirësimin e gjurmueshmërisë.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË


- Operacione që nuk kanë logjikë ekonomike/financiare - pasi vendosjes së parave kriminale në sistemin financiar, kriminelët janë të interesuar t'i shtresojnë në mënyrë që t'i bëjnë më pak të gjurmueshëm. Kjo arrihet duke kryer operacione të shumëfishta dhe duke i lëvizur fondet sa më shumë që të jetë e mundur, edhe nëse tarifatat janë të larta dhe operacionet duket se nuk kanë logjikë.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.

Rekomandim dhe hapat vijues

Tregtarët e këmbimit të monedhës nuk kanë kontrolle shumë të mira tradicionale të PPP/KFT-së, megjithatë një kufizim i rëndësishëm për PP/FT është se asnjë nga tregtarët e këmbimit të monedhës në Kosovë nuk mund të transferojë fonde tek subjektet e tjera raportuese, siç janë bankat.

Megjithatë, sektori po përjeton një kontroll të shtuar në mbarë botën, i cili mund dhe duhet të rrisë llogaridhënien brenda sektorit lokal. Subjektet raportuese dhe qeveria duhet të rrisin kontrollet dhe të përshtatin politikat dhe procedurat e tyre me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë me qëllimin për të rritur numrin e RAD-ve, si dhe cilësinë e tyre.





Bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare (BPPJF)

Nën-seksioni i mëposhtëm shqyrton risqet specifike për PPP të profesionistëve juridikë dhe jo-juridikë në kuadër të kategorisë së BPPJF-ve. Këto subjekte klasifikohen si të tilla nga FATF-i pasi ato posedojnë risqe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, por ato nuk mund të klasifikohen si institucione financiare.

Avokatët

Natyra dhe rangu i shërbimeve që ofrojnë avokatët janë të gjera. Këta profesionistë janë të kualifikuar t'i këshillojnë qytetarët në lidhje me ligjin dhe t'i përfaqësojnë ata në gjykatë.

Avokatët në Kosovë organizohen përmes Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK). Veprimtaria e Odës dhe organizimi i saj rregullohen nga Ligji për Avokatinë Nr. 04/L-193, Statuti i OAK-së dhe Kodi i Etikës për Avokatët; aktualisht ka mbi 800 avokatë praktikues në Kosovë, megjithatë shumica e tyre janë avokatë civilë ose penalë, dhe vetëm pak avokatë janë të përfshirë në transaksione ekonomike.

Avokatëve mund t'u kërkohet të ndihmojnë në strukturimin dhe dizajnin e transaksioneve që synojnë të fshehin natyrën dhe origjinën e fondeve. Organizatat kriminale mund të veprojnë në shkallë të ndryshme. Më të mëdhatë kanë shumë asete për t'u pastruar dhe kjo detyrë mund të jetë e vështirë të realizohet pa ndihmën e avokatëve dhe kontabilistëve. Për rrjedhojë, shumica e tipologjive të paraqitura në këtë dokument mund të supozojnë në një moment këshillimin/ndërmjetësimin me vetëdije të këtyre profesionistëve.

Risqet e korrupsionit në Odën e Avokatëve të Kosovës

Në vitin 2019, UNDP-ja në Kosovë lansoi vlerësimin e parë të riskut të korrupsionit të odës së Avokatëve (vegza). Ky ishte një vlerësim i kapacitetit të sistemit të Avokatët në Kosovë për të promovuar dhe mbështetur integritetin, për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin, dhe për të identifikuar faktorët brenda këtij sistemi që mund të çojnë në kërcënime ndaj këtij kapaciteti, ose t'i rrisin ato kërcënime, si dhe siguroi rekomandime për masat e zbutjes së riskut.

Një shënim mbi aktivitetet juridike

Aktivitetet juridike vetvetiu mbartin risqe të pastrimit të parave. Nëse klientët synojnë t'i keqpërdorin këto shërbime, profesionistët që zbatojnë ligjit mund të jenë të cenueshëm, zakonisht përmes metodave të mëposhtme:

- Keqpërdorimi i llogarive të klientit;
- Blerja e pasurive të patundshme;
- Krijimi i fondeve të mirëbesimit dhe kompanive;
- Menaxhimi i fondeve të mirëbesimit dhe kompanive;
- Menaxhimi i punëve të klientit dhe bërja e prezantimeve;
- Ndërmarrja e kontesteve të caktuara gjyqësore; dhe

- Themelimi dhe administrimi i bami-rësive

Një nga karakteristikat unike të sektorit të profesionistëve juridikë janë detyrimet etike të cilave u nënshtrohen:

Pavarësia (ofrimi i këshillave dhe përfaqësimit të pavarur, të paanshëm);

Ndershmëria, integriteti dhe drejtësia (këto standarde mbahen ndaj klientëve dhe kujtdo me të cilin bien në kontakt);

Konflikti i interesit (shmanget marrja e një pozite në të cilin interesi i një klienti bie ndesh me ato të avokatit, një avokati tjetër në të njëjtën firmë, ose një klienti tjetër, përveç nëse lejohet ndryshe);

Konfidencialiteti (mbahet dhe sigurohet mbrojtje e konfidencialitetit në lidhje me punët e klientëve aktualë ose të mëparshëm. Sidoqoftë, një profesionist juridik nuk mund të thirret në konfidencialitet në rrethanat kur ky profesionist vepron si bashkëpunëtor i një krimi);

Interesat e klientëve (këto interesa trajtohen si parësore, varësisht nga mungesa e konfliktit me detyrimet ndaj gjykatës dhe interesave të drejtësisë, duke u përmbajtur nga përfshirja ose dhënia e ndihmës klientëve me një sjellje që synon të mashtrrojë ose të ndikojë negativisht në interesat e drejtësisë).

Autoritetet dhe subjektet raportuese duhet të punojnë së bashku për t'i kuptuar dhe identifikuar më mirë interesat kriminale dhe për të shmangur aktivitetet me ta. Kjo, në fund të fundit, do të ulë depërtimin kriminal në të gjithë sistemin financiar dhe jo-financiar të Kosovës.

Sinjale alarmi për PPP

Avokatët mund të përfshihen në aktivitete kriminale përmes një larmie veprimtarish, pasi shërbimet që ata ofrojnë shkojnë nga hartimi i kontratave të punës, tek themelimi i kompanive dhe përfaqësimi i klientëve.

Kriminelët mund të përpiqen t'i ngatërojnë ose maskojnë lidhjet ndërmjet fitimeve të një krimi dhe autorit të krimit përmes krijimit të instrumenteve të korporatave ose aranzhimeve të tjera juridike (d.m.th. fonde të mirëbesimit). Kriminelët mund t'i përdorin transferet e pronave për të shërbyer si mbulesë për transfere të fondeve të paligjshme (shtresim) ose si investim përfundimtar të këtyre fitimeve pasi të pastrohen fitime nga krimi (integrimi).

Kriminelët mund t'i përdorin këta profesionistë për të kryer operacione të ndryshme financiare në emër të tyre (p.sh. depozitat në para të gatshme, op-


eracione të këmbimit të monedhës, blerje dhe shitje të aksioneve).

Vështirësia në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për ta identifikuar një klient është një nga sinjalet kryesorë të alarmit për PPP.

Kriminelët janë të interesuar ta maskojnë identitetin e tyre dhe/ose t'i pozicionojnë fitimet e paligjshme sa më larg që të jetë e mundur nga vetja. Avokatët bëhen të dobishëm në këtë detyrë pasi ata shpesh bëhen ndërmjetës. Në këtë mënyrë, njohja e klientit tuaj nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm në identifikimin e duhur të palëve, por edhe në të kuptuarit e burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve. Dokumentacionet fiktive që shërbejnë për këto besohet se janë një nga sinjalet më të shpeshtë të alarmit. Kriminelët mund të tregojnë interes edhe për krijimin e subjekteve juridikë tepër komplekse në vende me mbikëqyrje të dobët qeveritare. Avokatët duhet t'i interpretojnë këto interesa si sinjale alarmi për aq kohë sa nuk ka asnjë arsye për konfigurimin juridik të këtyre subjekteve përveç fshehjes së pronësisë përfituese të aseteve.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e avokatëve:

Tipologjia XVI




Subjekti A, i interesuar për të shitur një subjekt biznesi në Kosovë, dhe subjekti B, i interesuar për ta blerë, e kryejnë transaksionin përmes një firme juridike.

Sipas burimit të fondeve të subjektit B, të ardhurat vjetore nga aktiviteti i vet i biznesit nuk kanë asnjë lidhje logjike, e shumën që posedon për blerjen e subjektit të biznesit. Fondet për blerjen janë me origjinë të dyshimtë.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Burimi i paqartë i fondeve - subjektet raportuese duhet të bëjnë çmos për njohjen e klientit dhe që ta kuptojnë burimin e tij të fondeve.

Tipologjia XVII



Avokati vepron si ndërmjetës ndërmjet tre subjekteve të ndryshme të huaja të biznesit dhe subjekti A është pronari përfitues. Avokati është pronar, drejtor dhe i përfaqëson këto kompani në letër, kur në fakt është subjekti A që kryen këto operacione. Ky person nuk dëshiron që njësitë vendore të dinë për këto marrëdhënie.

Këto subjekte të huaja u konstatua se nuk paguanin tatimin përkatës tek autoritetet lokale dhe meqenëse subjekti A nuk ishte i lidhur direkt me këto njësi, gjetja e përfituesit përfundimtar ishte e ndërlikuar.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Pronësia e paqartë përfituese - personi (personat) fizik që në fund të fundit zotëron ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik, në emër të të cilit po kryhet një transaksion, mund të mos dëshirojë t'i shpalosë marrëdhëniet e tyre me subjektet specifike. Zakonisht, kjo ndodh kur kriminelët duan ta errësojnë pronësinë dhe kontrollin e tyre mbi asete të marra në mënyrë të paligjshme.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Rekomandim dhe hapat vijues

Ofrimi i këshillave juridike mbrohet nga privilegji mes avokatit dhe klienti, çka mund ta bëjë këtë marrëdhënie të biznesit më të turbullt për autoritetet kompetente. Kjo do të mbetet e vërtetë. Megjithatë, krahasuar me shumicën e vendeve të tjera evropiane, nuk ka treg të fondeve të mirëbesimit apo letrave me vlerë, të cilat mund të jenë një instrument i mundshëm për avokatët, dhe nuk ka as shenja se ndonjë avokat në Kosovë është i specializuar në krijimin e llogarive në det të hapur (offshore).

Ndërkohë që avokatët shfaqin disa shenja të të kuptuarit të risqeve të pastrimit të parave brenda sektorit, sektori është në fazën e hershme për sa i përket vetëdijimit të plotë për riskun e krimit financiar. Në vitin 2018 sektori paraqiti RTD për herë të parë, dhe Kosova mbetet e përkushtuar në rritjen e vetëdijes brenda profesionistëve të sektorit.

Avokatët do të mbeten një instrument i vlefshëm për grupet kriminale, pasi ata do të vazhdojnë të jenë instrument kur fshehin identitetin e vërtetë të pronarëve të kapitalit, qoftë me ndërmjetësimin e blerjes së pasurive të patundshme, ose përmes ekzekutimit të transaksioneve të

ndryshme financiare në emër të palëve të treta. Ndërkohë që rritet kontrolli mbi këtë sektor, kjo prirje pritet të ulet.

Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje për forcimin e mjedisit etik dhe profesional të juristëve dhe avokatëve, kurse lëshimi dhe mbajtja e licencave duhet të varet nga zbatimi i këtyre parimeve. Sektori duhet të bëhet plotësisht i vetëdijshëm për risqet e krimit financiar dhe mënyrën në të cilën aktivitetet e tyre mund të bëhen instrumentale për grupet kriminale, dhe ndikimin që ai përfundimisht i imponon sistemit financiar ndërkombëtar në tërësi.

Kontabilistët dhe auditorët

Kontabilistët profesionistë në praktikën publike mund të ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, të cilat përfshijnë shërbime të auditimit dhe sigurimit; mbajtjen e regjistrave dhe përgatitjen e llogarive vjetore dhe periodike, si dhe punën për pajtueshmërinë tatimore; shërbime mirëbesimi dhe të kompanisë.

Firmat më të mëdha ndërkombëtare të kontabilitetit që veprojnë në Kosovë, në përgjithësi zbatojnë politikat e tyre të PPP/KFT-së në nivel global, ndërkohë që kompanitë më të vogla shfaqin më shumë hendekë në njohuritë e tyre për riskun nga PP/FT të paraqitur nga klientët, dhe për detyrimet e tyre në sistemin e PPP/KFT-së.

Mungesa e raportimit të RTD-ve mund të jetë një shenjë se ka pak PP të lidhur me sektorin por ka më shumë gjasa të jetë një shenjë mungese e kontrollit dhe të kuptuarit të PPP/KFT-së në këtë sektor.

Sinjale alarmi për PPP


Disa nga shërbimet e ofruara nga këta profesionistë janë më të ndjeshme ndaj risqeve të pastrimit të parave.

Kur bëhet fjalë për kontabilistët dhe auditorët, kriminelët mund të jenë të interesuar të marrin këshilla se si t'i minimizojnë detyrimet tatimore ose t'i vendosin asetet aty ku nuk kontrollohen, për të shmangur detyrimet e ardhshme fiskale.

Kriminelët mund të jenë edhe të interesuar të marrin konfirmime për pasqyra financiare mashtruese, duke maskuar kështu performancën aktuale financiare të subjekteve të biznesit.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovës në sektorin e kontabilistëve dhe auditorëve:

Tipologjia XVIII




Detyrimet fiktive u krijuan me mbikëqyrjen e një kontabilisti. Subjekti i biznesit angazhohet një furnizues të rremë dhe një të punësuar të rremë që ra dakord të bëhej palë në një skemë me të cilën subjekti i biznesit do t'i llogariste shpenzimet e rreme në pasqyrën e të hyrave (d.m.th. shpenzimet për pagimin e pagës/kostos së mallrave të shitura).

Kjo rritje e rreme e shpenzimeve uli të hyrat e tatueshme dhe në këtë mënyrë shërbeu si një instrument për të shmangur pagesën e tatimeve.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Mospërputhja ndërmjet aseteve dhe detyrimeve - janë krijuar detyrime të rreme për të ulur të hyrat e tatueshme. Rënia në të hyrat e tatueshme ul detyrimet tatimore të subjektit të biznesit. Qeveria merr më pak të hyra ndërsa subjekti i biznesit nuk sheh një rritje të detyrimeve dhe shpenzimeve të veta.

Tipologjia XIX



Subjekti i biznesit, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e një kontabilisti, i ka fshirë në mënyrë të gabuar asetet nga bilanci i vet, duke rritur shpenzimet dhe kështu duke zvogëluar të hyrat e tatueshme.

Përveç evazionit tatimor, pronari përfitues mori pagesa për këto produkte që ishin fshirë. Nuk është paguar asnjë tatim për shitjen e këtyre produkteve.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Fshirjet fiktive - produktet e fshira supozojnë një shpenzim shtesë, i cili zvogëlon të hyrat e tatueshme dhe rrjedhimisht detyrimin tatimor që subjekti i biznesit ka me qeverinë. Fshirjet fiktive jo vetëm që çojnë në evazion tatimor, por mund të çojnë edhe në shitje të paligjshme të këtyre produkteve të fshira, të cilat rezultojnë në gjenerimin e fondeve të paligjshme pasi ky operacion është rezultat i evazionit tatimor, dhe nuk paguhet asnjë tatim më vonë për shitjen e këtyre produkteve.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.

Rekomandim dhe hapat vijues

Zhvillimi i ekonomisë së Kosovës sipas potencialit të saj të plotë aktualisht përdalohet edhe nga mungesa e transparencës së pronarëve të bizneseve. Kosova do të përfitonte shumë nga një regjistër më transparent dhe i saktë i pronësisë përfituese.

Kontabilistët mund të vazhdojnë të përdoren nga grupet kriminale për të pastruar para përmes krijimit të kontratave të rreme dhe/ose kontrollit të pasqyrave financiare mashtruese. Prandaj, ky sektor do të vazhdojë të jetë tërheqës për individët e interesuar për pastrim parash.

Ngjashëm me juristët dhe avokatët, duhet të bëhen përpjekje për forcimin e mjedisit etik dhe profesional, kurse lëshimi dhe mbajtja e licencave duhet të varet nga zbatimi i këtyre parimeve.

Sektori duhet të bëhet plotësisht i vetëdijshëm për risqet e krimit financiar dhe mënyrën në të cilën aktivitetet e tyre mund të bëhen instrumentale për grupet kriminale, dhe ndikimin që ai përfundimisht i imponon sistemit financiar ndërkombëtar në tërësi.

Subjektet dhe aranzhimet juridike

Instrumentet e korporatave (të referuara edhe si persona dhe aranzhime juridike) kryejnë një larmi të gjerë të aktiviteteve tregtare. Këtu, personat dhe aranzhimet juridike identifikohen si një sektor i veçantë për shkak të rëndësisë së tij ndërkombëtare dhe risqeve të pastrimit të parave dhe cenueshmërive që ai ka vetvetiu. Sidoqoftë, duhet të theksohet se këto aranzhime shpesh kryhen nga avokatë dhe kontabilistë dhe prandaj mund të konsiderohen edhe në kuadër të këtyre sektorëve.

“Personat juridikë” janë subjekte të ndryshme nga personat fizikë, dhe mund të krijojnë një marrëdhënie të klientit të përhershëm me një institucion financiar, ose përndryshe janë pronarë të pronave. Kjo mund të përfshijë kompani, organe të korporatave, fondacione, partneritete ose shoqata dhe subjekte të tjera të ngjashme që kanë personalitet juridik. Kjo mund të përfshijë organizata jofitimprurëse që mund të marrin forma të ndryshme, siç janë fondacionet, shoqatat ose shoqëritë bashkëpunuese. Llojet e ndryshme të personave juridikë ndryshojnë në bazë të juridiksioneve.

“Aranzhimet juridike”, nga ana tjetër, u referohen fondeve të mirëbesimit ose aranzhimeve të tjera të ngjashme.

Llojet e mëposhtme të personave juridikë mund të themelohen në Kosovë sipas legjislacionit në fuqi; biznesi Individual³, ortakëri i përgjithshme⁴, ortakëri e kufizuar⁵, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar⁶, shoqëri aksionare⁷, ose biznes personal⁸. Korniza e mbikëqyrjes për PPP/KFT është e konsoliduar, kryesisht nën BQK-në dhe NjIF-in. Për institucionet financiare, BQK-ja është autoriteti kryesor i licencimit dhe mbikëqyrjes, si për qëllimet PPP/KFT ashtu edhe për qëllimet jo të PPP/KFT-së. Në të njëjtën kohë përcaktohet edhe NjIF-i si mbikëqyrësi i PPP/KFT për IF-të.

Sinjale alarmi për PPP

Në kushte të caktuara, instrumentet e korporatave mund të keqpërdoren për qëllime të paligjshme, duke qenë se përbëjnë një mënyrë tërheqëse për të maskuar dhe konvertuar fitimet e kimit para se të futen në sistemin financiar.

Përdorimi i strukturave komplekse të korporatave (d.m.th. kompanive guacë dhe aksioneve të bartësve) është veçanërisht i cenueshëm ndaj aktivitetit të pastrimit të parave. Në këtë drejtim, mungesa e transparencës ndaj pronësisë përfituese është një risk i qartë me të cilin përballen të gjitha juridiksionet. Vendet përballen me sfida të rëndësishme kur zbatojnë masa për të siguruar disponueshmërinë në kohë të informacionit të saktë të pronarit përfitues, veçanërisht kur këtu përfshihen persona dhe aranzhime juridike në juridiksione të shumta.

Mungesa e informatave adekuate, të sakta dhe në kohë për pronësinë përfituese⁹ nga instrumentet e korporatave mund të lehtësojë pastrimin e parave duke maskuar:

- Pronësia juridike dhe përfituese: identifikimi i personave fizikë që mund të jenë përgjegjës për veprimtarinë problematike themelore. Në veçanti, informatat për pronësinë përfituese

- mund të errësohen përmes aranzhimeve të mëposhtme:
- o Kompanitë guacë: të krijuara me forma të ndryshme të strukturës së pronësisë dhe paraqesin risk veçanërisht në rastet kur pronësia e huaj është e shpërndarë nëpër juridiksione të ndryshme;
 - o Strukturat komplekse të pronësisë dhe kontrollit: zakonisht përfshijnë shumë shtresa të aksioneve të regjistruara në emër të personave të tjerë juridikë;
 - o Aksionet e bartësve dhe urdhrat e aksioneve të bartësve;
 - o Përdorimi i pakufizuar i personave juridikë si drejtorë;
 - o Aksionarët dhe drejtorët me nominim formal: kur nuk shpaloset identiteti i nominuesit;
 - o Aksionarët dhe drejtorët me nominim informal: si bashkëpunëtorë të ngushtë dhe familjarë;
 - o Fondet e mirëbesimit dhe aranzhimet e tjera juridike: mundësojnë ndarjen e pronësisë të ligjshme dhe pronësisë përfituese të asetëve;
 - o Përdorimi i ndërmjetësve në formimin e personave juridikë: përfshirë ndërmjetës profesionistë.
 - Qëllimi i llogarisë/pronës së mbajtur nga instrumenti i korporatës.
 - Burimi i fondeve.

Marrë parasysh përmasat e ekonomisë informale dhe se shumë prej llojeve të krimit në Kosovë kryesisht gjenerojnë të ardhura në formë të parave së gatshme, bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme janë të prirura për t'u keqpërdorur për PP. Përveç sektorëve të ndërtimitarisë dhe të lojërave të fatit, biznese të tjera në kuadër të sektorit të shitjeve me pakicë dhe shërbimeve, p.sh. bare dhe restorante, janë të cenueshme ndaj funksionimit si biznese që kombinojnë të ardhurat e paligjshme me të ardhurat nga operacionet e ligjshme, duke errësuar burimin, pronësinë dhe kontrollin e fondeve të paligjshme.

Kur një kompani përdoret si mbulesë për të depozituar, lëvizur ose përdorur të ardhura të paligjshme, mund të jetë e vështirë për bankën që mban llogarinë të dijë se aktiviteti bankar i kompanisë përfshin pastrimin e parave.


Informatat e pasakta në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive njihen gjerësisht si cenueshmëri e rëndësishme për pastrim të parave. Kompanitë guacë ose vendet në det të hapur konsiderohet se përdoren edhe për pastrimin e fitimeve, duke qenë se Policia e Kosovës ka hetuar disa raste të lidhura me transaksione me vende në det të hapur.

Për më tepër, informacioni i pasaktë i pronësisë përfituese u ka lejuar kompanive në Kosovë t'i devijojnë fondet publike që vijnë nga sjellja korruptive e lidhur me aktivitetet e prokurimit, ndërkohë që anashkalojnë kontrollin e PEP-ve nga bankat. Përdorimi i kompanive përfaqësuese pa transparencë të plotë të pronësisë përfituese besohet të jetë një strategji e përdorur shpesh për të pastruar fonde të paligjshme.

Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë vendimtarë. Regjistrimet e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare të mbajtura nga autoritetet e përfshira në regjistrimin e personave juridikë dhe autoritetet tatimore duhet të jenë të qasshme për autoritetet e zbatimit të ligjit.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë të lidhur me persona dhe aranzhime juridike:

Tipologjia XX




Subjekti A është një shtetas kosovar që themelon subjekte biznesi në Kosovë me dokumente të rreme. Përmes këtyre llogarive, subjekti A ka kanalizuar para, nga vetja dhe nga individë të tjerë, drejt një kompanie të huaj guacë që ndodhet në juridiksion me kërkesa të dobëta për shpalsje para subjekteve qeveritare.

Nga subjekti A ishte lëshuar një faturë e rremë me qëllim të justifikimit të pagesave nga subjektet B dhe C. Shërbimi i vetëm i ofruar nga subjekti A ishte nxjerrja e paligjshme e fondeve për të cilat nuk ishte paguar asnjë tatim në ATK. Kompania guacë ishte e strukturuar nga një avokat.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Persona kompleksë juridikë - Pronësi e paqartë përfituese. Personi (personat) fizik që në fund të fundit zotëron ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik, në emër të të cilit po kryhet një transaksion, mund të mos dëshirojë t'i shpalosë marrëdhëniet e tyre me subjektet specifike. Zakonisht, kjo ndodh kur kriminelët duan ta errësojnë pronësinë dhe kontrollin e tyre mbi asetet të marra në mënyrë të paligjshme.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

Tipologjia XXI



Subjekti A është një shtetas kosovar, i cili me ndihmën e një avokati lokal transferoi fonde në një kompani guacë, të vendosur në juridiksion tjetër. Fondet u transferuan lokalisht në llogarinë e avokatit si “tarifa juridike”, kur në fakt këto ishin fonde kriminale që transferoheshin jashtë vendit me qëllim pastrimit të tyre.

Kompania u gjet se nuk kishte një prani fizike, të punësuar ose aktivitet biznesi. Kompania ekskluzivisht lehtësoi transaksionet e tranzitit pa krijuar të hyra. Fondet e pastruara u kthyen më vonë në llogarinë bankare të subjektit A.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Persona kompleksë juridikë - Pronësi e paqartë përfituese. Personi (personat) fizik që në fund të fundit zotëron ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik, në emër të të cilit po kryhet një transaksion, mund të mos dëshirojë t'i shpallë marrëdhëniet e tyre me subjektet specifike. Zakonisht, kjo ndodh kur kriminelët duan ta errësojnë pronësinë dhe kontrollin e tyre mbi asetet të marra në mënyrë të paligjshme.
- Operacione ndërkuftare - transaksionet ndërkuftare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.

KDK - Pronësia përfituese

Pronësia përfituese i referohet personit (personave) fizik që në fund të fundit posedon ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik në emër të të cilit po kryhet një transaksion. Kjo përfshin edhe ata persona që ushtrojnë kontroll përfundimtar efektiv mbi një person ose aranzhim juridik.

Instrumentet e korporatave - siç janë kompanitë, fondet e mirëbesimit, fondacionet, partneritetet dhe llojet e tjera të personave dhe aranzhimeve juridike - kryejnë një larmi aktivitetesh tregtare dhe ndërmarrëse. Sidoqoftë, përkundër rolit thelbësor dhe legjitim që luajnë instrumentet e korporatave në ekonominë globale, në kushte të caktuara, ato janë keqpërdorur për qëllime të paligjshme, përfshirë pastrimin e parave (PP), ryshfetin dhe korrupsionin, ujdite e brendshme, mashtrimin tatimor, financimin e terrorizmit (FT), dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Kjo ndodh sepse për kriminelët që përpiqen të anashkalojnë masat për parandalimin e pastrimit të parave (PPP) dhe kundër financimit të terrorizmit (KFT), instrumentet e korporatave janë një mënyrë tërheqëse për të maskuar dhe konvertuar fitimet e krimit, përpara se t'i fusin në sistemin financiar.

Keqpërdorimi i instrumenteve të korporatave mund të zvogëlohet ndjeshëm nëse informacioni në lidhje me pronarin e ligjshëm dhe pronarin përfitues, burimin e aseteve të instrumentit të korporatës dhe aktivitetet e tij do të ishin të disponueshme për autoritetet. FATF ka publikuar një Udhëzim për Transparencën dhe Pronësinë Përfituese për t'u ndihmuar juridiksioneve dhe subjekteve raportuese në këtë temë (vegza).

Subjektet raportuese duhet të ndajnë burime shtesë për të identifikuar pronësinë përfituese të instrumenteve të mëposhtme, të cilat mund të errësojnë informacionin e pronësisë:

- Kompanitë guacë (kompani të regjistruara që nuk kanë veprimtari të rëndësishme ose asete të lidhura);
- Strukturat komplekse të pronësisë dhe kontrollit përfshijnë shumë shtresa të aksioneve të regjistruara në emër të personave të tjerë juridikë;
- Aksionet e bartësve dhe urdhrat e aksioneve të bartësve;
- Përdorimi i pakufizuar i personave juridikë si drejtorë;
- Aksionarët dhe drejtorët me nominim (in)formal;
- Fondet e mirëbesimit dhe aran-

- zhimet e tjera juridike mundësojnë ndarjen e pronësisë të ligjshme dhe pronësisë përfituese të aseteve;
- Përdorimi i ndërmjetësve në formimin e personave juridikë, përfshirë ndërmjetësit profesionistë.

Juridksionet kanë pranuar sfida të ndryshme në identifikimin e pronësisë përfituese të personave juridikë. FATF ka publikuar një punim mbi praktikën më të mirë për këtë çështje (vegza), një plotësim i Udhëzimit për fshehjen e pronësisë përfituese (vegza).

Noterët

Ngjashëm me Personat dhe aranzhimet juridiket, noterët konsiderohen si një sektor më vete, por ofrojnë një lloj shërbimi juridik. Ata janë me risk të konsiderueshëm marrë parasysh përmasat dhe rëndësinë e sektorit të pasurive të patundshme dhe të ndërtimtarisë në Kosovë.

Noterët në Kosovë organizohen përmes Odës së Noterëve të Kosovës (ONK). Ministri i Drejtësisë përcakton numrin e përgjithshëm të noterëve dhe mbulimin relativ për secilën komunë. Në Kosovë janë rreth 80 noterë. Noterët mund të përfshihen në të gjitha transaksionet që lidhen me shitjen e pronave të luajtshme dhe të patundshme, duke përfshirë pasurinë e patundshme, dhe si të tillë kanë një rol shtesë në regjimin parandalues për transaksionet e patundshmërive.

Këta profesionistë kanë tendencë të kenë një rol të rëndësishëm në kuadër të sektorit të BPPJF-ve, pasi ata janë të përfshirë në shumicën e transaksioneve që lidhen me formimin e kompanive dhe transferimin e pasurive të patundshme.

Sinjale alarmi për PPP


Noterët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në pastrimin e të ardhurave, por vepronë si mundësues për shpëlarësit. Rasti i përgjithshëm është blerja e një prone me çmim të nënvlerësuar, me çmimin që pranohet nëpërmjet noterit. Fitimet e paligjshme më pas do të përdoren për të paguar “nën tryezë” për pjesën e mbetur. Më vonë prona mund të shitet me çmim të plotë. Noterët janë gjithnjë të përfshirë në këto transaksione, por jo gjithmonë janë të vetëdijshëm për implikimet penale.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë të lidhura me noterët:

Vlerësimi i riskut të korrupsionit për Odën e Noterëve të Kosovës

Në vitin 2019, UNDP-ja në Kosovë lansoi vlerësimin e parë të riskut të korrupsionit të Odës së Noterëve (vegza). Ky ishte një vlerësim i kapacitetit të noterëve në Kosovë për të promovuar dhe mbështetur integritetin, për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin, dhe për të identifikuar faktorët brenda këtij sistemi që mund të çojnë në kërcënime ndaj këtij kapaciteti, ose t'i rrisin ato kërcënime, si dhe siguroi rekomandime për masat e zbutjes së riskut.

Tipologjia XXII



Noteri ndërmjetësoi në shitjen e një pasurie të patundshme në Kosovë. Sipas kontratës çmimi i pronës ka një vlerë dukshëm nën çmimin e tregut. Tatimi u paguar në këtë çmim (70% e çmimit të pasurive të patundshme).

Subjektet A dhe B, me ndihmën e noterit, dakordohen për një pagesë shtesë të përgjithshme dhe në para të gatshme për 30 përqindëshin e mbetur të çmimit sipas vlerës së tregut të pronës. Nuk paguhet asnjë tatim për këtë transaksion në para të gatshme.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Çmimi i pronës së patundshme është i gabuar - çmimi zyrtar i transaksionit të pasurive të patundshme është dukshëm më i ulët/më i lartë se çmimi i tregut. Nëse është dukshëm më i ulët, palët në transaksion mund të jenë të interesuara për uljen e pagesave tatimore; nëse është dukshëm më i lartë, palët mund të jenë të interesuara të simulojnë shpenzime më të larta për të kërkuar lehtësime tatimore.

Rekomandim dhe hapat vijues

Është e qartë se ky sektor ka bërë përpjekje për të rritur vetëdijesimin për risqet e pastrimit të parave. Dëshmi e kësaj është fakti që RTD-të e dorëzuara nga subjektet raportuese u rritën nga 0 në vitin 2014 në 30 në vitin 2018 dhe 68 në vitin 2019.

Përpjekjet duhet ende të përhapen në të gjithë sektorin. Mospërputhja e çmimeve të pasurive të patundshme dhe pronave, një nga sinjalet kryesore të alarmit për PPP brenda këtij sektori, ka shumë gjasa të mbetet një kërcënim në të ardhmen e afërt. Luhatshmëria e lartë e çmimeve të pasurive të patundshme në Kosovë dhe rritja e tyre e vazhdueshme (veçanërisht në qytetet më të mëdha) lehtëson spekulimet me mospërputhjen e çmimeve.

Noterët duhet të bëhen më të vetëdijshëm për çmimet e tregut të aseteve. Zhvillimi i një baze të dhënash të centralizuar mund të jetë një masë që vlen të hulumtohet me qëllim të mbajtjes së një regjistrimi të çmimeve të tregut të pasurive të patundshme.

Tregtarët me vlera të larta

Tregtarët me vlera të larta përcaktohen si tregtarë që tregtojnë a) metale dhe gurë të çmuar (MGÇ); dhe b) vetura, kryesisht të shtrenjta/luksi. Ekzistojnë disa qindra tregtarë të MGÇ-ve të vendosura anembanë Kosovës që shkojnë nga tregtarët e mëdhenj tek të vegjël dhe që janë mjaft të qasshëm për klientët vendas.

Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar mund të jenë individë ose persona juridikë. Ata duhet të vërtetohen nga Instituti i Metrologjisë Ligjore i Kosovës - aktualisht Agjencia e Metrologjisë në kuadër të MTI-së.

Tregtarët me vlera të larta që bëjnë tregti në mallra me pagesa në para të gatshme prej 10,000 eurosh ose më shumë në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh të lidhura ose transaksionesh dukshëm të lidhura, duhet të zbatojnë masat e KDK-së për transaksione të tilla, të mbajnë shënime adekuate për transaksionet, dhe TMGÇ-të përcaktohen në mënyrë specifike si subjekte raportuese që duhet të raportojnë transaksione të dyshimta, nëse zbulohen.

Ky sektor supozon risqe të mëdha të pastrimit të parave pasi tregtia e tij ka natyrë

globale. Kjo sugjeron që gjurmimi i palëve në transaksione është sfidues, duke krijuar vështirësi shtesë për agjencitë e zbatimit të ligjit të interesuara për kryerjen e hetimeve.

Për më tepër, marrë parasysh vlerën e lartë të këtyre aseteve, organizatat kriminale mund t'i përdorin si monedhë. Metalët e çmuara mund të jenë një monedhë më e mirë për këtë qëllim, pasi ato mund të ofrojnë anonimitet të plotë për mbajtësit e tyre, ndërsa veturat kërkojnë një kontroll më të lartë.

Tregtia e metaleve të çmuar, duke qenë se këto zakonisht shkëmbehen për para të gatshme, mund të supozojë një sfidë edhe më të lartë për agjencitë qeveritare.


Sinjale alarmi për PPP

Ngjashëm me sektorin e noterëve, sinjali më i madh i alarmit është mospërputhja e çmimeve. Kriminelët mund të jenë të interesuar të pastrojnë fitime të paligjshme përmes tregtisë së këtyre aseteve, pasi vlera e tyre është e lartë dhe ato ofrojnë nivele të larta të anonimitetit. Sa më e lartë të jetë vlera që kriminelët u caktojnë këtyre aseteve, aq më shpejt ata do të jenë në gjendje t'i pastrojnë paratë kriminale.

Përndryshe, njerëzit mund të jenë të interesuar të raportojnë një pjesë të pagesës tek autoritetet lokale me qëllim shmangien së tatimeve. Në këtë rast, kriminelët nuk do ta përdorin këtë sektor për të vendosur fitime të paligjshme, por ata do të krijojnë fitime të paligjshme përmes evazionit tatimor, të cilat më pas do të duhet të pastrohen.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e tregtarëve me vlera të larta:

Tipologjia XXIII



Subjekti A, i interesuar për të shitur një subjekt biznesi në Kosovë, dhe subjekti B, i interesuar për ta blerë, e kryejnë transaksionin përmes një firme juridike. Sipas burimit të fondeve të subjektit B, të ardhurat vjetore nga aktiviteti i vet i biznesit nuk kanë asnjë lidhje logjike, e shumë më që posedon për blerjen e subjektit të biznesit.

Fondet për blerjen janë me origjinë të dyshimtë.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Subjekti i biznesit me çmim të gabuar - çmimi zyrtar i transaksionit të subjektit të biznesit është dukshëm më i ulët/më i lartë se çmimi i tregut. Nëse është dukshëm më i ulët, palët në transaksion mund të jenë të interesuara për uljen e pagesave tatimore; nëse është dukshëm më i lartë, palët mund të jenë të interesuara të simulojnë shpenzime më të larta për të kërkuar lehtësime tatimore.

Rekomandim dhe hapat vijues

Jo të gjithë profesionistët në këtë sektor janë të vetëdijshëm ose respektojnë detyrimet për PPP/KFT. Është e rëndësishme të rritet vetëdija dhe kontrolli mbi operacionet e bëra nga këta profesionistë. Me vendosjen e më shumë rregulloreve në sistemin financiar, pritet të rriten operacionet kriminale nëpër sistemet jofinanciare.

Marrë parasysh vlerën e lartë, nivelet e larta të anonimitetit dhe nivelet e ulëta rregullatore të këtyre sektorëve, pritet që të rritet tregtimi i këtyre produkteve. Profesionistët duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre në njohjen e klientëve të tyre, identitetit të tyre, burimeve të pasurisë dhe fondeve, si dhe në arsyetimin e operacioneve në të cilat janë përfshirë.

Patundshmëria dhe ndërtimtaria

Sektori i pasurive të patundshme (pro-na në formën e tokës ose ndërtesave) përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh që mund të klasifikohen në tre grupe të ndryshme sipas OECD-së, sipas fazës së biznesit:

- Zhvillimi i terrenit;
- Procesi i ndërtimit;
- Ndërtimi i mbaruar.

Sinjale alarmi për PPP

Pasuritë e patundshme janë përshkruar si një nga mënyrat më të vjetra të njohura për pastrimin e parave, pasi është një investim i qëndrueshëm, është funksional dhe konsiderohet gjithashtu si një ofrues i respektueshmërisë, ligjshmërisë dhe normalitetit. Për më tepër, transaksionet e pasurive të patundshme mund të përfshijnë shuma të mëdha dhe i nënshtrohen një kontrolli më të kufizuar për PP, në krahasim me transaksionet që lidhen me sektorin financiar. Blerja e pasurisë së patundshme është një mënyrë e integritit të parave të zeza në ekonominë e ligjshme.

Dallimi ndërmjet secilës fazë të përmendur më lart nuk mund të injorohet lidhjen e

rasteve të zbuluara në faza të ndryshme, kurse të kuptuarit e mirë të mekanizmave të transmetimit të pastrimit të parave në pasuri të patundshme është thelbësor për të ndihmuar në identifikimin e rasteve të dyshimta dhe përfaqëson një faktor kyç kur hartohen strategji për të trajtuar problemet e zbuluara në sektor. Pronësia e fshehur dhe përdorimi i shtetasve të huaj janë dy shembuj që paraqesin nevojën për të kuptuar mekanizmat e transmetimit brenda sektorit: pronësia e fshehur është zakonisht e pranishme gjatë zhvillimit të terrenit dhe procesit të ndërtimit; ndërsa PP përmes përdorimit të shtetasve të huaj ka qenë një strategji e përdorur nga kompanitë vendase të ndërtimtarisë në Irlandë, ku shtetas të huaj ishin të punësuar në mënyrë të paligjshme, duke pastruar kështu fitimet e paligjshme si rezultat i pagesave të padeklaruara dhe mashtrimeve taktimorë. Ishte gjithashtu e qartë se disa punëdhënës përdorën shtetas të huaj për t'i devijuar fondet me qëllim të fshehjes së fitimeve.

Pastrimi i parave përmes transaksioneve të pasurive të patundshme i integron fondet e zeza në ekonominë e ligjshme ndërkohë që siguron një investim të sigurt. Përdoren teknika të ndryshme:

- Skema të turbullta financimi;
- Çmime të mbivlerësuara/nënvlerësuara;
- Kompani, fonde mirëbesimi ose palët të tjera jo transparente.

Pastrimi i parave përmes pasurive të patundshme ka një ndikim të prekshëm në ekonomi. Shtrembërimi i çmimeve mund të çojë në rritjen e tyre, çka zvogëlon përballueshmërinë e strehimit, diçka që ka qenë e dukshme si në ekonominë në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara. Për më tepër, ulje-ngritjet e çmimeve të strehimit dhe mungesa e banesave dhe zyrave të përballueshme mund të nxisin mundësi për investime të huaja. Sa i përket lidhjes ndërmjet investimeve të huaja në pasuri të patundshme dhe pastrimit të parave, nuk ka të dhëna të prekshme, por treguesit gjenden në çmimet e larta që përfshijnë pagesa më të larta se vlera.


Duhet të kihet parasysh se sektori i ndërtimtarisë shërben si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Kosovës, dhe përkundër sfidave ka vazhduar të zgjerohet edhe gjatë krizës ekonomike në Evropë. Me një pjesëmarrje prej 9.5%, sektori i ndërtimtarisë ishte punëdhënësi i katërt më i madh në Kosovë në vitin 2014, duke punësuar rreth 39.000 persona. IHD-të në Kosovë gjatë viteve 2011-

2016 ishin kryesisht të përqendruar në patundshmëri me 56.3%, dhe ndërtimtari me 12.7%. Kur trajtohet ky sektor, është e rëndësishme të pranohet se ai përbën një kërcënim për PP për shkak të niveleve të larta të informalitetit në kuadër të sektorit, në të cilin është i përhapur evazionitativor nga pagesat e padeklaruara/nën-vlerësuara.

Një rast tipik i pastrimit të parave në ndërtim shpesh përfshin investimin e një sasive të madhe parash nga një individ që shfaqet si klient dhe një shitje tjetër më pas, e cila fsheh origjinën e paligjshme të parave të investuara në punët ndërtimore fillestare.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e pasurive të patundshme dhe ndërtimtarisë:

Tipologjia XXIV




Paratë e gatshme të futura në sistemin financiar të Kosovës janë marrë në shtetin X. Sistemi bankar kosovar është përdorur për të pas-truar paratë përmes vendosjes dhe shtresimit të fondeve. Fondet u përdorën më pas për të investuar në pasuri të patundshme në shtetin X. Nuk u bë asnjë deklaratë në kufi për paratë e gatshme.

Shtetasi i huaj A këmbënguli të investonte në pasuri të patundshme në para të gatshme (jo përmes sistemit bankar). Ai pretendon se është i interesuar të shmangë tarifën e transaksionit, por kjo nuk është në përputhje me sjelljet e mëparshme.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Transaksioni në para të gatshme për pasuri të patundshme - kur subjektet përpiqen të paguajnë në para të gatshme për prona të patundshme duhet të jepet sinjal alarmi. Transaksionet e pasurive të patundshme kërkohet të bëhen përmes sistemit bankar për të rritur transparencën në kuadër të sektorit të pasurive të patundshme dhe ndër-timtarisë.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.
- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.

Tipologjia XXV




Subjekti A ka marrë në llogarinë e vet bankare në Kosovë një depozitë me vlerë të lartë prej 400,000 eurosh me përshkrimin "bujqësore dhe kursime familjare". Këto fonde më pas transferohen tek djali i vet, një pronar biznesi, i cili përfundimisht i transferon këto fonde jashtë vendit për blerjen e pasurive të patundshme. Subjekti B përdor llogarinë e subjektit të tij të biznesit për t'i shtresuar më tej fondet e paligjshme. Produktet e kredive u përdorën në mënyrë sistematike si instrument për operacionet bankare. Këto kredi nuk u pasuan nga shlyerjet e kredive.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.

Tipologjia XXVI




Subjektet A dhe B bëjnë depozita në para të gatshme nën pragun e raportimit. Pas vendosjes së fondeve të paligjshme në sistemin bankar të Kosovës, subjektet vazhdojnë t'i shtresojnë përmes depozitave me afat, investimeve dhe lëvizjes së fondeve ndërmjet llogarive.

Më vonë, këto fonde tërhiqen ose përdoren për blerjen e pasurive të patundshme në Kosovë. Llogaritë e përdorura për vendosjen dhe shtresimin e fondeve janë private, gjë që zvogëlon transparencën e operacioneve.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Smurfing - tërheqje të shumëfishta dhe të njëpasnjëshme të parave të gatshme në kartëmonedha 500 euro. Nëse këto transaksione do të ishin bashkuar në një të vetëm, do të raportohej tek autoritetet lokale. Përmes smurfing-ut kriminelët zakonisht i integrojnë fondet e pastruara në ekonomi.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.
- Operacione që nuk kanë logjikë ekonomike/financiare - pasi vendosjes së parave kriminale në sistemin financiar, kriminelët janë të interesuar t'i shtresojnë në mënyrë që t'i bëjnë më pak të gjurmueshëm. Kjo arrihet duke kryer operacione të shumëfishta dhe duke i lëvizur fondet sa më shumë që të jetë e mundur, edhe nëse tarifat janë të larta dhe operacionet duket se nuk kanë logjikë.

Tipologjia XXVII




Subjekti A pastron para që vijnë nga evazioni tatimor përmes shtresimit të fondeve ndërmjet llogarive të subjekteve B dhe C (në lidhje me A). Fondet transferohen brenda dhe jashtë Kosovës nën konceptin e kredive, por këto kredi nuk shlyhen kurrë.

Pas shtresimit, këto fonde integrohen në ekonomi përmes blerjes së pasurive të patundshme dhe përmes ri-investimit të tyre në subjektin e huaj të biznesit në pronësi të individit A.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Operacione ndërkufitare - transaksionet ndërkufitare rrisin vështirësinë e gjurmimit të fondeve. Zakonisht kërkohet bashkëpunim ndërkombëtar kur ndërmerren hetime, kurse kriminelëve u ofrojnë shtresim të mëtejshëm të fondeve kriminale.
- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.

Tipologjia XXVIII




Paratë e gatshme depozitohen në llogaritë e subjekteve A dhe B. Këto depozita arrijnë në 1,000,000 euro.

Paratë e depozituara në 5 llogaritë private të subjektit A nuk janë deklaruar në autoritetin vendor tatimor (ATK). Fondet zhvendosen ndërmjet llogarive nga subjektet A dhe B dhe më vonë përdoren për blerjen e pasurive të patundshme.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.
- Operacione me para të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme. Prandaj, operacionet me para të gatshme me vlerë të lartë mund të lidhen me aktivitete të paligjshme dhe duhet t'u nënshtrohen analizave.
- Llogaritë private - për shkak të nivelit më të ulët të transparencës së këtyre produkteve, këto llogari ulin gjurmueshmërinë e fondeve.

Tipologjia XXIX



Transaksionet e pasurive të patundshme dhe të hyrat nga pensioni nuk justifikojnë operacionet e individit B. Për më tepër, kreditë nuk përcillen nga shlyerja e kredisë. Paratë e gatshme të padeklaruara zhvendosen ndërmjet llogarive të ndryshme dhe përfundimisht përdoren për blerjen e pasurive të patundshme.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Kredi - këto produkte mund të supozojnë një risk më të lartë të pastrimit të parave pasi kriminelët zakonisht i lidhin fondet e paligjshme me një emetim ose pagesë kredie.
- Burimi i paqartë i fondeve - subjektet raportuese duhet të bëjnë çmos për njohjen e klientit dhe që ta kuptojnë burimin e tij të fondeve.

PEP-të dhe klientët me risk më të lartë

Sipas qasjes së bazuar në risk, institucioneve të rregulluara u kërkohet të caktojnë kategori të ndryshme risqesh për klientët e tyre në mënyrë që të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientit dhe monitorimin e vazhdueshëm në një mënyrë proporcionale me risqet që ata përfaqësojnë.

Institucionet duhet të kryejnë kujdesin e duhur të zgjeruar (KDZ) dhe monitorim të vazhdueshëm të zgjeruar në situata me risk më të lartë, të cilat përfshijnë por nuk duhet të kufizohen në:

- klientët e lidhur me vendet ose sektorët e biznesit me risk më të lartë;
- klientët me struktura të turbullta, të paqarta, ose të komplikuar të pronësisë përfituese;
- klientët e lidhur me transaksione që janë të pazakonta, nuk kanë një qëllim të dukshëm ekonomik ose të ligjshëm, janë komplekse ose të mëdha, ose mund të shërbejnë për anonimitet.

Personat e ekspozuar politikisht janë individë, pozita e spikatur e të cilëve në jetën publike mund t'i ekspozojë ata dhe familjen e tyre të ngushtë ndaj korrupsionit. Për shkak të riskut të pastrimit të parave

që përfaqësojnë PEP-të, edhe këta duhet t'i nënshtrohen KDZ-së. Në vitin 2018, Kosova lansoi Raportin e parë për Tipologjitë e Pastrimit të Parave ose PEP-të (vegza).

Rekomandim dhe hapat vijues

Çdo transaksion për shitjen/blerjen e pasurisë mbi 10,000 euro në vlerë duhet të shlyhet nëpërmjet një transferi bankar, përndryshe nuk do të regjistrohet në kadastër, prandaj bankat kanë një rol të mundshëm parandalues në monitorimin e transaksioneve të patundshmërive. Kjo vepron si një pengesë ndaj keqpërdorimit të këtij sektori, por ai mbetet tërheqës për organizatat kriminale, veçanërisht për fazën e integritit të fitimeve të pastruara.

Aktivitetet e ndërtimtarisë pritet të rriten gjatë viteve në vijim me rritjen e turizmit në rajon, ndërkohë që infrastruktura aktuale (d.m.th. hotelet) është dëshmuar se është e pamjaftueshme. Kërkesat e rritura për lidhje dhe transport më të mirë publik mund të rrisin aktivitetet e ndërtimtarisë. Veçanërisht, infrastruktura rrugore konsiderohet një aset i rëndësishëm publik në Kosovë, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Është rritur kërkesa për cilësi më të mirë të banesave urbane, zyrave, ndërtesave qeveritare dhe shkollave, çka do të çojë në më shumë ndërtim të rrugëve, autostradave dhe projekteve të tjera të infrastrukturës.

Për më tepër, zhvillimi i rrjetit hekurudhor do të mbetet thelbësor për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Të gjitha këto projekte do të kërkojnë një kontroll më të madh, pasi korrupsioni në kuadër të këtij sektori është i lartë. Sipas KDI-së, në vitin 2016, nga 9.1 milionë euro të shpenzuara për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale, gjithsej 1.9 milion euro u humbën nga korrupsioni.

Duhet të bëhen përpjekje për përmirësimin e procedurave të prokurimit, të cilat sipas Zyrës Kombëtare e Auditimit janë zakonisht të vonuara. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka sugjeruar që Kosova të krijojë një njësi qendrore që merret me zbatimin e projekteve për ta përshpejtuar këtë proces.

Sa u përket aktiviteteve të pasurive të pa-tundshme, duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për identifikimin e PEP-ve dhe kryerjen e KDK-ve përkatëse për ta.

Kazinotë dhe lojërat e fatit

Sektori i ligjshëm i lojërave të fatit mund të përfshijë një larmi aktivitete, duke përfshirë kazinotë, lotaritë, lojëra online, baste sportive, lojëra për bamirësi, si bingo dhe lojëra të tjera të teknologjisë së ulët.

Gjatë dekadës së kaluar, tregu i kazinove ka përjetuar një rritje eksponenciale për shkak të rrjedhave të mëdha të të ardhurave të gjeneruara për ofruesit dhe për qeverinë përmes tatimeve dhe tarifave të licencimit. Sidoqoftë, vende të ndryshme po i dallojnë gjithnjë e më shumë dëmet shoqërore të lidhura me këto aktivitete dhe për këtë arsye janë përpjekur ta kufizojnë rritjen e lojërave të fatit në një përpjekje për të frenuar rritjen e kostove sociale.

Në mars të vitit 2019, qeveria e Kosovës nxorri një vendim për pezullimin e veprimtarisë së të gjitha lojërave të fatit. Pavarësisht kësaj, ky raport do të përfshijë analizën e këtij sektori pasi objektivi nuk është vetëm ofrimi i një tipologjie për të përballuar më mirë kërcënimet aktuale dhe të ardhshme të pastrimit të parave në Kosovë, por edhe për të vlerësuar kërcënimet ndaj të cilave juridiksioni ka qenë i ekspozuar.

Ka pasur 41 lokale të lojërave të fatit në Kosovë (përfshirë makina elektronike, bingo, tombola, lokale të basteve sportive dhe 1 lotari publike), por asnjë kazino të regjistruar.

Sinjale alarmi për PPP

Në përgjithësi, aktiviteti fizik i kazinove në nivel global është i konsiderueshëm, ka përdorim intensiv të parave të gatshme, dhe është i cenusshëm ndaj shfrytëzimit kriminal. Disa nga karakteristikat e sektorit që lehtësojnë ekspozimin ndaj risqeve të pastrimit të parave janë:


- Natyra me përdorim intensiv të parave të gatshme, shpesh janë hapur 24 orë në ditë, me vëllime të larta të transaksioneve të mëdha në para të gatshme që ndodhin shumë shpejt;
 - Oferta e shërbimeve të ndryshme financiare, d.m.th llogari, remitanca, këmbim i monedhës, emetim i parave të gatshme;
 - Rregullimi i dobët në disa juridiksione;
 - Vendndodhja në rajone të karakterizuara nga qeverisje e dobët, paqëndrueshmëri politike ose rajone kufitare me aktivitet të rëndësishëm kriminal;
 - Lëvizja komplekse e fondeve;
 - Qarkullim i lartë i stafit, çka mund të çojë në dobësi në trajnimin e stafit për PPP.
- Më konkretisht, në këtë sektor janë vëzhguar historikisht aktivitetet e mëposhtme të pastrimit të parave:
- Chipa për çekun e kazinosë, tërheqje nga banka ose transferin e parave: kriminelët zakonisht blejnë chipa me para të gatshme ose përmes llogarisë së tyre në kazino, dhe shlyerja kërkohet më pas me çek, tërheqje ose transfer të tërhequr në llogarinë e kazinosë. Kjo metodë mund të bëhet më e turbullt duke përdorur një zinxhir kazinosh ku chipat shndërrohen në kredi dhe transferohen në një juridiksion tjetër në të cilin zinxhiri i kazinosë e ka një strukturë;
 - Chipa “të pastra” me çmim të fryrë: kriminelët mund të blejnë chipa me prapavijë të pastër, dhe kjo shpesh njihet si “ngatërrim i vlerës”;
 - Çeqet e kazinosë të pagueshme në para të gatshme: në disa juridiksione, kazinotë lejojnë që çeqet për fituesit të bëhen të pagueshme në “para të gatshme”, të cilat mund të vijnë nga dhoma VIP, dhe që mund të ofrojnë shërbime alternative të remitancave ndërmjet juridiksionit të shtetit së llogarit dhe dhomave VIP të kazinosë;
 - Fitimi dhe paratë e gatshme në çeqet e kazinosë: edhe pse janë të pakta juridiksionet që e lejojnë këtë, kriminelët përpiqen të shtojnë para të gatshme në fitimet në kazino, dhe më pas të këmbëjnë paratë e gatshme dhe fitimet për një çek të vetëm;
 - Chipa si monedhë në transaksione të paligjshme: pastruesit e parave mund

të mbajnë chipa të kazinove që të përdoren si monedhë për të blerë drogë ose mallra të tjera të paligjshme. Marrësi i chipave më vonë do t'i arkëtojë në kazino. Këto aktivitete mund të zhvillohen ndërmjet kufijve dhe shumica e juridiksioneve nuk i rendisin chipat e kazinove si instrumente të vlerës së parave dhe për këtë arsye nuk kërkojnë deklarim doganor;

- Numër i madh i blerjeve të "certifikatave të dhuratave të kazinove": pas-truesit e parave mund të blejnë një vlerë të lartë të certifikatave të shumta me vlerë së ulët të dhuratave të kazinove, të cilat mund të merren nga palë të treta. Këto certifikata u shiten ose u jepen personave të tjerë;
- Kartelat e shpërblimeve të kazinove: fondet e paligjshme mund të përdoren edhe për të blerë kartela të shpërblimeve në kazino nga klientë të ligjshëm, duke u paguar atyre një prim mbi vlerën e shpërblimit.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë risqet e pastrimit të parave ndaj të cilave ishte e ekspozuar Kosova në kuadër të sektorit të kazinove dhe lojërave të fatit:

Tipologjia XXX



Fondet janë me origjinë nga juridiksione të ndryshme me risk më të lartë dhe transferohen në llogari bankare në Kosovë. Subjekti A, një lojtar pokeri, kryen tërheqje me vlerë të lartë të parave të gatshme dhe pagesa me kartelë krediti në hotele dhe kazino të vendosura në juridiksione me risk më të lartë. Nuk ka asnjë marrëdhënie të dukshme ndërmjet individëve.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Lojërat e fatit - kazinotë dhe loja e fatit konsiderohen si një aktivitet me risk të lartë pasi operacionet zakonisht kryhen me para të gatshme dhe informacioni i kërkuar nga palët për burimet e fondeve vlerësohet si i pamjaftueshëm për të trajtuar riskun e krimit financiar. Kriminelët mund të injektojnë para të paligjshme në këtë sektor, duke nxjerrë para "të pastra" më pas.
- Operacione me përdorim intensiv të parave të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme dhe ka gjasa të vendosin fonde në sistemin financiar në formën e parave të gatshme.
- Juridiksione me risk më të lartë - transaksioni ndërkuftar mund të përfaqësojë një tregues të riskut të lartë pasi komplikon gjurmueshmërinë e fondeve. Nëse juridiksionet e përfshira janë me risk më të lartë, do të thotë se konsiderohen nga FATF si vende që nuk mund t'i trajtojnë në mënyrë efektive risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, atëherë kjo do të supozonte një risk shtesë. Institucionet duhet të jenë shumë vigjilente ndaj palëve të vendosura në këto juridiksione.

Rekomandime dhe hapat vijues

Kazinotë dhe lojërat e fatit nuk janë të ligjshme në Kosovë dhe nuk pritet të bëhen të ligjshme në të ardhmen e afërt. Sidoqoftë, qeveria dhe subjektet raportuese duhet të mbeten vigjilente ndaj operacioneve të klientëve të tyre, pasi kjo veprimtari mbetet me risk të lartë dhe klientët ende mund të jenë në gjendje të operojnë brenda këtij sektori nga Kosova, siç ilustruhet nga tipologjia.

Subjektet duhet të ndihen të qetë me klientët që përdorin këto produkte, pasi këto produkte janë përdorur historikisht për të pastruar fitimet e paligjshme.

Organizatrat jo-fitimprurëse (OJF)

Një OJF është një person ose aranzhim juridik që kryesisht synon të mbledhë para ose të ndajë fonde në projekte të tilla si bamirësi, fe, kulturë dhe arsim, qëllime sociale dhe vëllazërore.

Kosova ka një sektor të gjerë dhe të larmishëm të OJQ-ve ,me pothuajse 10,000 OJQ të regjistruara që përmbushin shumë role të rëndësishme për shoqërinë në Kosovë. OJQ-të zakonisht financohen nga donacionet, por disa shmangen krejtësisht nga financimet formale dhe drejtohen kryesisht nga vullnetarë. Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ-të (DRNOJQ) në kuadër të Ministrisë për Administratë Publike, është autoriteti kompetent për zbatimin e Ligjit për OJQ-tëLirinë e Asocimit në OJQ.

Sinjale alarmi për PPP


Shumica e OJQ-ve në Kosovë marrin fonde publike në një farë mase, dhe ka pasur raste kur politikanët kanë shfrytëzuar cenueshmëritë e mbikëqyrjes financiare të OJQ-ve që t'i përdorin për të devijuar financimin publik për përfitime personale, dhe në mënyrë të ngjashme OJQ-të mund të funksionojnë edhe si një mjet për rryshfet.

Prandaj, për shkak të ekspozimit të lartë të sektorit ndaj subjekteve qeveritare dhe zyrtarëve publikë, palët e PEP-ve duhet të japin sinjal alarmi dhe të nxisin një KDK më shteruese.

Për më tepër, qeveria duhet të mbetet vigjilente ndaj objektivave të shpalosura nga ata individë të interesuar për regjistrimin e OJQ-ve në Kosovë. Për shkak të niveleve më të ulëta të kontrollit të këtyre organizatave, kriminelët mund t'i përdorin për të pastruar fitime të paligjshme.

Duhet të theksohet se përveç pastrimit të parave, mbledhja e fondeve për bamirësi nga OJQ-të ngjall shqetësim në lidhje me financimin e terrorizmit. Fonde të tilla mund të mblidhen për arsye të deklaruara të mbështetjes së ndihmës humanitare në zonat e konfliktit, ndërkohë që fondet në të vërtetë janë të destinuara për organizatat terroriste.

Tipologjia XXXI



Subjekti A, i cili drejtonte biznese të ndryshme kriminale në Kosovë, financoi një bamirësi me qëllim të ofrimit të mbështetjes për një komunitet specifik. Bamirësia u regjistrua në rregullatorin kombëtar dhe u deklaruan dhurime të ndryshme. Këto fonde ishin të ardhura nga vepërtaria e biznesit e subjektit A, të hyra që nuk ishin deklaruar siç duhet pranë autoritetit kombëtar tatimor.

Përmes bamirësisë, subjekti A pastroi fondet që rezultuan nga evazioni tatimor. Këto fonde nuk ishin të destinuara për bamirësi.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- Organizatat jofitimprurëse - kriminelët mund t'i përdorin këto institucione për të pas-truar para, pasi ato zakonisht operojnë me para të gatshme dhe kontrolli i fondeve ka qenë historikisht më pak shterues në krahasim me sektorët e tjerë. Për më tepër, këto institucione u nënshtrohen regjimeve të ndryshme tatimore, të cilat mund t'u ofrojnë kriminelëve një mundësi për të shmangur tatimet.
- Operacione me përdorim intensiv të parave të gatshme - duke qenë se normalisht nuk është e mundur të gjurmohet lidhja e individëve me paratë e gatshme, kriminelët zakonisht operojnë me para të gatshme dhe ka gjasa të vendosin fonde në sistemin financiar në formën e parave të gatshme.

Rekomandim dhe hapat vijues

NjIF-K dhe organizata të tjera relevante bashkëpunojnë me Departamentin e Qeverisë për OJQ për të kryer hetimet e kujdesit të duhur në lidhje me personat e huaj që kërkojnë të regjistrojnë OJQ dhe/ose që punojnë në kuadër të këtyre organizatave.

Megjithatë, NjIF nuk ka qasje në bazat e të dhënave komerciale të NJKT/KDK-së për të kontrolluar personat e lidhur me OJQ-të e huaja. Mungon NJKT/KDK e detajuar kur regjistrohen OJQ të reja, dhe mungojnë aftësitë në kuadër të Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve.

Qeveria duhet të jetë plotësisht e vetëdijshme për përmasat, shkallën dhe vëllimet e operuara në këtë sektor. OJF-të do të mbesin tërheqëse për shkak të niveleve të larta të besimit dhe sepse themelohen në një mjedis më të thjeshtë rregullator, i cili supozon një pengesë të ulët ndaj hyrjes. Fondet ndërmjet këtyre organizatave do të vazhdojnë të përdoren në transaksione pa pasur nevojë të japin asgjë në këmbim dhe anëtarët e organizatave të përmendura i nënshtrohen pak ose aspak llogaridhënies.

Risqet do të vazhdojnë të jenë veçanërisht më të larta kur fondet janë me origjinë ose të destinuar për juridiksione me risqe më të larta. Mungesa e mekanizmave efikase për verifikimin e burimit të fondeve që vijnë në OJF/OJQ nga vende të huaja është një problem i veçantë në Kosovë.

Shënime:

- 1 Ky dokument e interpreton "cenueshmërinë" si: gjërat që mund të shfrytëzohen nga një kërcënim ose që mund të mbështesin ose lehtësojnë aktivitetet e tij. Në kuadër të kontekstit të PP/FT-së, vlerësimi i cenueshmërive nënkupton shqyrtimin e faktorëve që paraqesin dobësi në sistemet ose kontrollet e PPP/KFT-së në kuadër të një juridiksioni. Gjithashtu, mund të përfshijë tiparet e një sektori të caktuar, një produkti financiar ose lloji shërbimi që i bën atraktive për qëllime të PP-së dhe/ose FT-së.
- 2 Për më shumë informata, referojuni Vlerësimi të Rrezikut Kombëtar të Kosovës.
- 3 Një subjekt që mund të formohet dhe të zotërohet vetëm nga një person fizik.
- 4 Një subjekt që mund të formohet dhe të zotërohet vetëm nga një person fizik.
- 5 Një ortakëri e formuar nga të paktën një ortak i përgjithshëm dhe një ortak i kufizuar.
- 6 Një person juridik i formuar dhe i zotëruar nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, duke përjashtuar OJF-të.
- 7 Një person juridik në pronësi të aksionarëve të vet, por ligjërish i ndarë dhe i dallueshëm nga aksionarët e vet.
- 8 Nuk ka personalitet juridik.
- 9 Pronësia përfituese i referohet personit (personave) fizik që në fund të fundit posedon ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik në emër të të cilit po kryhet një transaksion. Kjo përfshin edhe ata persona që ushtrojnë kontroll përfundimtar efektiv mbi një person ose aranzhim juridik. [Fjalor-thi i rekomandimeve të FATF].